

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

JANAR SHKURT MARS 2026

	Data e kerkeses	Objekti	Pergjigjie	Menyra e perfundimit te kerkeses	Tarifa
	30.12.26	Une i nenshkruari ismail qefalija banues ne Njesine Bashkiake Nr.4, Rr. Fitnete rexha Tirane, po ju drejtoj kerkesen time per problematiken si me poshte : Ne rrugen Fitnete Rexha, Tirane po behen prishje te banesave dhe rrugeve per t'i lene vend ndertimit te segmentit rrugor "Unaze e Madhe" Tirane, loti nr.6. Kjo rruge eshte mar si shesh ndertimi nga firma ndertuese "Gjoka Construction" shpk duke na bllokuar dhe mos lejuar te zhvillojme aktivitetet tona ditore nevojat shendetesore etj. Ne jemi pro zhvillimit por duke qene se zhvillimi prek rugen ku ne kalojme dhe banojme kerkojme nga ana juaj te meren masa per hapjen e nje rruge tjeter alternative. Jane disa alternativa per hapjen e rruges	1.1.2026	Ne pergjigje te ankeses se meposhteme ju sqarojme se Rruga Fitnete Rexha nuk ben pjese ne inventarin e rrjetit rrugor kombetar qe administrohet nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.	Pa pagese
	1.1.2026	Pershendetje Kemi 1 vit pa rrug tek rruga fitnete rexha dhe asnje pergjigje nga ju.			
	3.1.2026	Pershendetje Autoriti rrjgve ne si banore shqetësimin e Rruges nga rruga kryesore Dritaj per ne njësinë Administrative Stravaj edhe rruga katastrofe ka 30 vite qe seshte vene dore fare kur do asfaltohet ndonjer kjo rruge jemi ne mëshire te fati interesojuni njere si i behet Rruga			

		Dritaj per njesin Administrative Stravaj Bashkija Prenjas ju ju lutemi intereso juni, Shpetim Uruci			
5.1.2026		Dua të verifikoj nëse është regjistruar një aplikim për leje hyrje-dalje për pronën e mëposhtme, pasi aplikimi duhet të jetë kryer nga inxhinieri Ermir Isedisha. Firma: EA Engineering. Rruga nacionale Burrel-Klos[SH6] ,ne km 15+850. Të dhënat e pronës: Pronari: Xhevahir Ramazan Doka dhe Bijane Shaqir Doka Numri i aplikimit :MIE-2025-3497352-AS Vendndodhja: Fshati Pleshe, Nj.A. Klos, Bashkia Klos Pasuria: Nr. 161/8, ZK 2990 – 3003 m² Kufijtë: V.161/7, J.161/5, L.161/3, P.1130 Koordinatat: 41.511375, 20.091714 Ju lutem më njoftoni nëse figura që aplikimi është regjistruar në sistem dhe në cilën fazë ndodhet. Faleminderit! Me respekt Xhevahir Doka. Numri i telefonit:0683278042			
3.10.2025		Ne datën 11.04.2025 kemi depozituar pranë ARRSH kërkesën për përfitim shpronësimi, sipas VKM nr. 866 datë 27.12.2022 “Shpronësim për interes publik të pronarëve të pasurive të luajtshme, prone private që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor ‘Sistemim, asfaltim e masa inxhinierike në km 21+050+22+050, në rrugën Qafe Thane –Pogradec”. Masa e përfituar ende nuk ka kaluar. Lutem informimin nga ana juaj në lidhje me kërkesën tonë.	17.9.2025		

		Faleminderit Perfituesit: Llazi Sotir Lala Astrita Sotir Lala, Tatjana Sotir Adhami, Sotiraq Llazi Lala			
7.1.2026		Dua të verifikoj nëse është regjistruar një aplikim për leje hyrje-dalje për pronën e mëposhtme, pasi aplikimi duhet të jetë kryer nga inxhinieri Ermir Isedisha. Firma: EA Engineering. Rruga nacionale Burrel-Klos[SH6] ,ne km 15+850. Të dhënat e pronës: Pronari: Xhevahir Ramazan Doka dhe Bijane Shaqir Doka Numri i aplikimit :MIE-2025-3497352-AS Vendndodhja: Fshati Pleshe, Nj.A. Klos, Bashkia Klos Pasuria: Nr. 161/8, ZK 2990 – 3003 m² Kufijtë: V.161/7, J.161/5, L.161/3, P.1130 Koordinatat: 41.511375, 20.091714 Xhevahir Doka			
16.12.2025	• Zgjerimi i autostradës Tiranë – Durrës ○ A konfirmoni që zgjerimi i 5 km të parë të autostradës do të përfundojë në dhjetor 2025? ○ Cila është masa aktuale e përfundimit të punimeve për këtë segment?	7.1.2026	Afati i përfundimit të kontratës “ Zgjerimi i superstradës Tiranë – Durrës (Faza I) ” është 24.05.2026. Pritshmëritë janë që përfundojnë shtresat asfaltike por mbetet pjesa e urës pranë “kullës Eifel” pa u mbyllur Brenda Dhjetorit 2025.		

	○ A ka faktorë që mund të ndikojnë në vonesë të afatit të dhënë? ○ Pas përfundimit të këtyre 5 km, a ka plan për fazat e tjera të zgjerimit dhe cilat janë afatet e tyre? ○ Specifikoni edhe kostot sipas fazave, edhe totalin ● Aksi rrugor Kombinat – Ndroq – Plepa dhe Ura e Beshirit ○ Cila fazë e rindërtimit aktualisht po kryhet? ○ Cilat janë afatet për përfundimin e secilës fazë? ○ Kur pritet që Ura e Beshirit të jetë funksionale dhe të eliminojë kthesat e rrezikshme? Esmeralda Topi		Afati i përfundimit të kontratës “Zgjerimi i superstradës Tiranë – Durrës (Faza II)” është 15.09.2026. Kanë përfunduar deri më tani 87% e punimeve të kontratës tek kontrata “Zgjerimi i superstradës Tiranë – Durrës (Faza I)” Kanë përfunduar deri më tani 86% e punimeve të kontratës tek kontrata “Zgjerimi i superstradës Tiranë – Durrës (Faza II)” Faktore qe mund te ndikojne eshte procesi i shpronësimeve qe akoma nuk eshte permbyllur. Nuk jane 5 km por 6 km per dy fazat e para. Nderkohe ka filluar edhe faza e trete. oja e “Zgjerimi i superstradës Tiranë – Durrës (Faza I)” është 1,654,181,828 lekë me TVSH Kostoja e “Zgjerimi i superstradës Tiranë – Durrës (Faza II)” është 1,786,939,479.00 lekë me TVSH Kostoja e “Zgjerimi i superstradës Tiranë – Durrës (Faza III)” është 2,367,307,288.88 lekë me TVSH rata e zbatimit " Zgjerimi i superstrades Tirane - Durres " Faza III nga km-6 km 7+050 perfshire mbikalimin e Kasharit si dhe mbikalimin e Laknasit eshte lidhur me date 09.10.2025 dhe ka afatin e perfundimit te punimeve 18 muaj kalendarik. Punimet ne kontraten " Rikonstruksion i rruges se vjeter Kombinat - Ndroq - Plepa" Loti 1 eshte realizuar ne masen 76% te vleres se kontrates. Punimet sipas kontrates perfundojne ne Maj 2026.	
7.1.2026	E kisha vendosur qe mos te shkruaja me sepse eshte e kote me ju por po ju nis nje foto tani qe po kthehesha.			

		Ky furgoni perfundoi ne kanal nga balta qe ka mbulu rrugen ne Mallkuc fiks aty ku kam disa muaj qe ju raportoj dhe aty ku ju nisa sot foto qe keni lene fadromen 100 metra me tutje te parkuar KOT. A ju dhimbset fadroma apo si eshte problemi? E paguajme ne ate jo ju, se ju sjeni per asigje sja keni haberin, ne kohen kur une iki per pune ne mengjes dhe kthehem ne darke ju jeni ne gjume. Dmth ju lej ne gjume dhe ju gjej ne gjume. Do e kompensoni kete furgonin qe ka rene ne kanal ne Mallkuc? Pls na mbani te informuar. Shpresoj qe nje dite tju shoh juve ne kte kanal ose femijet tuaj sepse KARMA kshu funksionon dhe ta dini dhe ju ndjesine sesi ndihemi ne keto raste. Hamid Mirdita			
	10.1.2026	Doja te dija a eshte e kalueshme rruga Leskovik - Përmet ju lutem? Maria Koca			
	10.1.2026	I am writing to formally report several ongoing and daily issues along Unaza e Madhe in Tirana, which significantly affect public safety and hygiene. These issues include: Large amounts of trash along the roadside Dead stray dogs left for days on the side of the road Non-functioning lighting on multiple sections, I observe these problems every single day while commuting, but I am unable to take photos as I am driving. Nonetheless, the issues are persistent and clearly visible. I kindly ask that this report be forwarded to the appropriate departments for inspection and immediate action. Amaro Falzetta	10.1.2926		
	13.1.2026	Kam bërë një aplikim në platformën e-albania për lëshim certifikatë pronësie, lëshim kopje karteletë të pasurisë, lëshim kopje të fragmentit të hartës kadastrale, regjistrim i aktit të trashëgimisë, regjistrim i bashkimit ose ndarjes të pasurisë së paluajtshme, regjistrim i kalimit të pronësisë me anë të ligjit,	13.1.2025		

	të vendimit të gjykatës apo të një akti administrative, drejtuar Drejtorisë Vendore ASHK Tirana Rurale II. Ju drejtohem me këtë kërkesë për informacion dhe dokumentacion zyrtar nëse për pasurinë time nr. 976/53 zk 2105 ka VKM shpronësimi apo jo. Për të bërë të mundur marrjen e shërbimeve nga Drejtoria Vendore ASHK Tirana Rurale II. Ju lutem përgjigjia që kërkon DVASHK Tirana Rurale II është nëse ka apo jo VKM shpronësimi për pasurinë në fjalë, sipas situatës së tanishme jo se cfarë mund të ndodhi në të ardhmen. Bashkëlidhur gjeni shkresën nr. 6067/2 prot., datë 30.10.2025 mbi hartën kadastrale të lëshuar nga DVASHK Tirana Rurale II si dhe shkresën nr. 7994/3 prot., datë 10.11.2025 të lëshuar nga Autoriteti Rrugor Shqiptar. Kërkesën time për informacion dhe dokumentacion zyrtar e kam dërguar dhe në rrugë postare në (ARRSH) Autoriteti Rrugor Shqiptar, më datë 16.12.2025. Duke ju falenderuar dhe shpresuar një përgjigje sa më shpejtë të jetë e mundur pasi jam në limitet e aplikimit. Me respekt Bedrije Sulaj			
12.1.2026	Uroj te jeni mire, dua te njoftoj per shembjen e rruges dhe shembjen e tubave qe kanalizojne nje lum te vogel (perrua) ne Rrugen Haziz Veliu, Dajt Tirane. Situata eshte shume serioze sepse kolapsi i rruges dhe nje pjese toke, nuk lejon levizjen e makinave dhe te qytetareve. Me poshte po ju bashkengjis foto dhe video te situates, gjithashtu dhe vendodhjen. Ju lutem merni masa! Me respekt Kristina Balliu!	13.1.2026	Ne pergjigje te ankeses se meposhteme ardhur nga banori Kristina Balliu, sqarojme se rruga Haziz Veliu, Dajt, Tirane, nuk ben pjese ne inventarin e rrjetit rrugor kombetar qe administrohet nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.	

14.1.2026	Dua të verifikoj nëse është regjistruar një aplikim për leje hyrje-dalje për pronën e mëposhtme, pasi aplikimi duhet të jetë kryer nga inxhinieri Ermir Isedisha. Firma: EA Engineering. Rruga nacionale Burrel-Klos[SH6] ,ne km 15+850. Të dhënat e pronës: Pronari: Xhevahir Ramazan Doka dhe Bijane Shaqir Doka Numri i aplikimit :MIE-2025-3497352-AS Vendndodhja: Fshati Pleshe, Nj.A. Klos, Bashkia Klos Pasuria: Nr. 161/8, ZK 2990 – 3003 m² Kufijtë: V.161/7, J.161/5, L.161/3, P.1130 Koordinatat: 41.511375, 20.091714			
14.1.2026	Kërkojmë nga ana juaj dhënien e informacionit nëse ka një manual / dokumentacion tjetër i miratuar për distancat kilometrike të qyteteve. Nëse ju e dispononi një dokumentacion të miratuar kërkojmë nga ana juaj të na e vendosni në dispozicion. Në pritje të një përgjigje, sa më shpejt të jetë e mundur.	14.1.2026	Matrica e distancave kilometrike e miratuar eshte ne faqen e ARRSH.	
14.1.2026	Te nderuar pershendetje! Uroj te jeni mire! Jam Granit Sokolaj, drejtues i Emisionit ALERT. Kete te premtë, paz zhvillimeve te pas-festave dhe ngjarjeve qe ndodhen ne rruge, dua te zhvilloj nje teme sensnbilizuese "Ngrica dhe goma vere". Tema ka te beje me ndergjegjesimin e shqiptareve me shume, sepse edhe vet personalisht takova nje lushnjar ne Valbone, qe kishte shkuar e goma vere, e pyeste si t'ia bej? Por diskutojme dhe per gjithë problematikat e mundshme ne rruge, ngricat, bllokimet, masat e ndermarra etj.	14.1.2026	Arjana Hasani pergjegjese sektori prane Drejtorise se Mirembajtjes ARRSH.	

		Ne panel po ftoj dhe Policine e Shtetit, si dhe eksperte te sigurise rrugore. Emisioni eshte te premten ne oren 21.00 ne Ora News. Ne pritje te konfirmimit nga ana juaj, me respekt, Granit Sokolaj.			
14.1.2026		Ju lutem kemi nevoj per nje informacion nga ana juaj. A ka nje projekt per baypasin e city park? Behet fjale per tu ndertuar nje rruge mbrapa city parkut.qe lidh rrugen dytesore Vore-Tirane. Midis rruges Mulliri i vjeter, dhe rruges Rruga e Limuthit a do te kete nje lidhje te ketyre 2 rrugeve?	15.1.2026	Lidhur me informacionin e kerkuar ju bejme me dije se per te siguruar vazhdimesine e rruges dytesore, projekti i zgjerimit te rruges Tirane - Durres parashikon ndertimin e nje anashkalimi ne anen jugore te qendres tregetare City Park. Kjo rruge do te lidhe rrugen e Limuthit me rrugen Mulliri i Vjeter	
14.1.2026		Lutem gjeni bashkelidhur per trajtim dhe kompetencë kërkesën për informacion të deputetit Kliti Hoti në lidhje me projektin për ndërtimin e urës së re të Bahçallëkut, në zbatim nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.	14.1.2026	Në përgjigje tuajës me Nr.3787 Prot dt.03.12.2025 “ <i>Kërkesë për informacion</i> ”, dërguar me email, bashkelidhur do gjeni informacionin mbi sa kërkon: Kontrata : “Ndërtim rruga kthesa e Bërdicës – Ura e Bahçallëkut” Kjo kontratë nuk parashikon vetëm ndërtimin e urës së re të Bahçallëkut por edhe : - Ndërtimi i një segmenti rrugor sipas kategorise D – urbane që lidh nyjen e qytetit të Shkodrës me Tiranën dhe Velipojën. - Ndërtimin e urës së re të Bahçallëkut mbi lumin Drin. - Parashikimin e nyjes në nivel që bën shpërndarjen e trafikut në mënyrë të sigurtë. - Parashikimin e mbikalimeve të këmbësorëve në qoftë se gjykohet e nevojshme. - Parashikimin e ndriçimit urban, për të rritur sigurinë rrugore. Vlera e Kontratës: 992,051,483.4 lekë (me TVSH) (s’ka ndryshim) Data e fillimit të punimeve 23.12.2024	

				Data e përfundimit të punimeve 23.06.2026 (s'ka shtyrje afati deri tani) Bashkëlidhur do gjeni kopje të scanuara të kontratave (Kushtet e Përgjithshme të Kontratës dhe Kushtet e Veçanta të Kontratës). Në kontratën bashkëlidhur do gjeni (në faqen e parë të kontratës) emrat e kompanive dhe personave përgjegjës. Nën / Kontraktorë Kjo kontratë nuk ka nën/kontraktorë. Planin e punimeve dhe fazat e zbatimit, bashkë me statusin Aktual Grafiku i punimeve (bashkëlidhur). Aktualisht po kryhen punime per realizimin e shpatullës në aksin 1 dhe punime për realizimin e pilotave në aksin 9. Raportet e inspektimeve teknike, cilësisë dhe sigurisë Këto janë pjesë e dokumentacionit teknik që mbahet në kantier dhe dorëzohen në përfundim të projektit, kur bëhet kolaudimi i punimeve në objektit)	
--	--	--	--	--	--

				Detajet mbi garancitë kontraktuale, mënyrën e pagesave dhe penalitet per vonesa integrale e kontratës bashkëlidhur. Këto janë pjesë Çdo kërkesë për financime shtesë, arësyet dhe vendimarrjet përkatëse Deri në këtë moment s'ka asnjë kërkesë për financim shtesë apo për shtyrje afati Informacion për transparencën dhe njoftimet publike të bëra për qytetarët. Këto janë pjesë e fazës së projektimit dhe janë bërë nga projektuesi pranë Institucioneve përkatëse dhe Bashkisë Shkodër. Ky projekt është hartuar sipas Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër, i miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit. (kopje bashkelidhur)	
--	--	--	--	---	--

				Në lidhje me zgjidhjen e projektit teknik të urës së re të Bahçallëkut ju sqarojmë : Përsa i përket alternativave të projektimit (me dy këmbë në ujë apo me tre këmbë në ujë) theksojmë se varianti i miratuar nga ARRSH-ja është varianti me 6 hapësira drite, i paraqitur nga projektuesi, i cili ka marrë në konsideratë të gjithë faktorët e detajet për zonën në fjalë.	
14.1.2026	Rruga Fier-Berat ne fshatin Zharrez prej disa muajsh eshte bere burim problemi per shume shofere perfshi edhe une qe po ju shkruaj Per shkak te nje grope ne rruge jane care mbi 40 goma makine perfshi edhe mua Kush mban pergjegjesi per kete? Kus...	14.1.2026	Ne pergjigje te ankeses se mesiperme, pas verifikimit ne terren te situates, mgjthse pas reshjeve u kryen riparime per gropat, u evidentua nje e tille ne fshatin Zharrez per riparimin e se ciles u nderhy menjehere nga kompania. Edhe nga fotot bashkengjitur duket qe kjo grope ka qene e mbushur por si rezultat i reshjeve materiali ka levizur. Bashkengjitur fotot para dhe pas riparimit.		
17.1.2026	Me anë të këtij e-mail-i dëshiroj të raportoj një situatë tepër problematike në zonën (lagjen) ku unë banoj, e cila prek drejtpërdrejt të gjithë banorët e saj dhe kërkon ndërhyrje të menjëhershme nga ana juaj. Bëhet fjalë për zonën e banuar mbrapa kompleksit sportiv “Tenis Tirana”, në qytetin e Tiranës, ku aksesimi realizohet nga vazhdimi i rrugës Reshit Çollaku në drejtim të shkollës “Dora d’Istria”, ndërsa përfundimi i rrugës bëhet pranë ish-barit të njohur “Syri i Kalter”, tashmë i shembur, në rrugën Myslym Shyri. Nga fillimi i kësaj rruge, përballë shkollës “Dora d’Istria”, dhe deri në fund të saj, mungon plotësisht sinjalistika që tregon se kjo është një rrugë “PA DALJE” drejt rrugës Myslym Shyri. Për pasojë, një numër i madh automjesh, në mënyrë të panevojshme dhe të gabuar, hyjnë në këtë rrugë me qëllimin për të dalë në Myslym Shyri, duke krijuar trafik të shtuar, konfuzion dhe rrezik për banorët.	19.1.2026	Kerkesen tuaj po e dergojme /delegojme prane Bashkise Tirane si pergjegjesi e tyre. ARRSh eshte pergjegjese per rruget nacionale.		

		Kjo situatë ka sjellë shqetësime serioze për komunitetin e zonës, duke përfshirë: • Trafik të panevojshëm dhe të vazhdueshëm në një rrugë të ngushtë banimi; • Vështirësi reale për banorët për të hyrë dhe dalë nga zona për shkak të fluksit të makinave; • Ndotje akustike dhe prishje të qetësisë publike; • Rritje të rrezikut për aksidente dhe dëmtime të pronës. Dua të theksoj se personalisht kam pësuar dëmtime materiale në dy automjete të ndryshme, një në pronësinë time dhe një në pronësinë e babait tim, të shkaktuara nga automjete që nuk janë të zonës dhe që kanë hyrë gabimisht në këtë rrugë me qëllimin për të dalë nga ana tjetër, pra për shkak të mungesës së sinjalistikës së duhur. Përveç kësaj, ekziston edhe një problem i dytë po aq serioz, i cili e përkeqëson ndjeshëm situatën: përcaktimi i gabuar i kësaj rruge në aplikacionin Google Maps. Aktualisht, Google Maps e paraqet këtë rrugë si një vazhdim me dalje në rrugën Myslym Shyri, gjë që nuk është e vërtetë. Kjo ka bërë që jo vetëm drejtues automjeteve shqiptarë, por edhe shtetas të huaj, të cilët mbështeten plotësisht në navigimin e aplikacionit, të futen gabimisht në këtë rrugë pa dalje. Si pasojë, ata përballen me vështirësi të mëdha për të manovruar dhe për t'u kthyer mbrapsht, duke shtuar më tej trafikun, rrezikun dhe kaosin në zonë. Si një zgjidhje të parë, të shpejtë dhe të realizueshme pa vështirësi, kërkoj vendosjen urgjente të të paktën një table sinjalistike që përcakton qartë tipologjinë e kësaj rruge si “RRUGË PA DALJE”. Kjo do të ulte ndjeshëm fluksin e automjeteve që hyjnë gabimisht në zonë.			
--	--	--	--	--	--

	Po aq e rëndësishme dhe e domosdoshme është edhe ndërhyrja juaj për raportimin dhe korrigjimin zyrtar të këtij gabimi në Google Maps. Si përdorues të thjeshtë, ne nuk kemi mundësi reale për të përditësuar dhe korrigjuar saktësinë e hartave, ndaj ju jeni i vetmi autoritet institucional që mund të ndikojë në rregullimin e këtij problemi, i cili sot është një nga shkaqet kryesore të trafikut të panevojshëm në këtë zonë. Për referencë, jam i gatshëm t’ju dërgoj vendndodhjen e saktë (location) si dhe fotografi të zonës përkatëse, në mënyrë që problematika të jetë sa më e qartë dhe e dokumentuar. Ju lutem të merrni në konsideratë këtë kërkesë me seriozitetin maksimal dhe të ndërmerrni masat e nevojshme për zgjidhjen e këtij problemi, pasi shqetësimi i banorëve të kësaj zone është i madh dhe i vazhdueshëm, dhe ndërhyrja juaj është jetike për përmirësimin e sigurisë, qetësisë dhe funksionimit normal të kësaj rruge.			
17.1.2026	Rruga Fier-Berat ne fshatin Zharrez prej disa muajsh eshte bere burim problemi per shume shofere perfshi edhe une qe po ju shkruaj Per shkak te nje grope ne rruge jane care mbi 40 goma makine perfshi edhe mua Kush mban pergjegjesi per kete? Kus...	19.1.2026	Ne pergjigje te ankeses se mesiperme, pas verifikimit ne terren te situates, mgjse pas reshjeve u kryen riparime per gropat, u evidentua nje e tille ne fshatin Zharrez per riparimin e se ciles u nderhy menjehere nga kompania. Edhe nga fotot bashkengjitur duket qe kjo grope ka qene e mbushur por si rezultat i reshjeve materiali ka levizur. Bashkengjitur fotot para dhe pas riparimit.	
30.9.2025	Jemi ALNet ISP dhe jemi në fazën e planifikimit të shtrirjes së rrjetit me fibër optike në segmentin Thumanë–Kashar. Për këtë qëllim kemi kontaktuar kompaninë koncesionare “Gener 2”, të cilët na kanë konfirmuar se nga ana e tyre nuk ka pengesë, por se miratimi për shfrytëzimin e tubacionit përgjatë/autostradës është në kompetencë të Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARrSh).	17.1.2026	Emali me poshte u delegua tek konçesionari ne MIE!	

	Në këtë kuadër, ju lutemi të na informoni: - Cila është procedura që duhet ndjekur për të aplikuar për leje shfrytëzimi tubacioni në segmentin Thumanë–Kashar - Çfarë dokumentacioni kërkohet për aplikim - Nëse ekziston një formular ose platformë specifike ku duhet të paraqitet kërkesa. Qëllimi ynë është të kalojmë fibër optike nga Thumana drejt Kasharit duke përdorur infrastrukturën ekzistuese të tubacioneve, në përputhje të plotë me rregullat teknike dhe ligjore në fuqi. Ju falënderojmë paraprakisht për bashkëpunimin dhe presim udhëzimet tuaja për hapat e mëtejshëm. Me respekt, ALNet ISP +355 684740479			
15.1.2026	Lidhur me punimet me punimet qe po kryhen nga ana e firmes GJOKA KONSTRUKSION (Ish GJOKA) në segmentin nga Kryqëzimi I Patosit – Fratar ashtu sic jeni ne dijeni kompania ONE Albania (ish Albtelecom) ka ndërtuar nje infrastrukturë nëntokësore të fibrave optike BB, e cila lidh Shqipërinë e Jugut me Greqine. Gjate kesaj periudhe ku po behen punime nga ana e fimes GJOKA KONSTRUKSION ne kete segment kablli i fibres optike bashke me infrastrukturen eshte demtuar shume here dhe traseja ku kalon ky link FO eshte nxjerre jashte perdorimit . Demtimet e shpeshta gjate kryerjes se ketyre punimeve kemi pasur afektim te sherbimeve qe lidhen institucione dhe operatore te ndryshem nderkombetare , si dhe shërbime të një rëndesie te vecantë sic është ndërlidhja për kompaninë Albcontrol Vlore me partnerët e saj ndërkombëtar,Dogana e Kakavijes dhe komplet qytetet e Jugut te Shqiperise(pavarsisht qe ne terren jemi suportuar nga ana e kompanise ne fjale). Duke pare qe kompania GJOKA KONSTRUKSION po ben ndertimin e nje linje per Telefonine sipas projektit te ARSH-se kemi kerkuar nga ana e firmes ne fjale te vendoset shiriti i sinjalizimit me Logon ONE pasi ne kete segment kompania ONE Albania (ish Albtelecom) ka qene e vetmja	21.1.2026	Në vijim të përgjigjes së mëposhtme si dhe akt-marrëveshjes datë 17.01.2011 të lidhur midis ish-Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve, sot Autoriteti Rrugor Shqiptar, ju informojmë edhe një herë se; Kontraktori i punimeve është instruktuar të mbështesë kompaninë tuaj për bashkërendimin e punimeve dhe vendosjen nga ana juaj të shiritit sinjalizues apo cdo element tjetër të procesit të punës. Referuar marrëveshjes së sipërpërmendur konkretisht Neni VII, të gjitha shpenzimet për spostimin e linjës do të zbatohen nga kompania juaj.	

		kompani qe ka ndërtuar nje infrastrukturë nëntokësore të fibrave optike BB, e cila lidh Shqipërinë e Jugut me Greqinë dhe qe eshte demtuar nga keto punime. Prandaj ashtu sic dhe kemi komunikuar pergjate ketyre diteve kerkojme nga ana juaj suportin tuaj per vendosjen e shiritit dallues me Logon ONE Albania . Ne attach do te gjeni edhe fotot nga demtimi I infrastruktures se fibres optike ne segmentin Kthesa e Patosit-Balsh-Fratar.			
21.1.2026		Prsh dritat rrugore lin_pogradec jane djegur me shume se gjysma 5 cop fikur 1 ndezur askush nuk interesohet ti rregulloje kaq e veshtire qenka per ti rregulluar,keta punonjesit qe e mirmabajne pse nuk i rregullojnë,eshte nje rruge qe krenohet shqiperia per ndriçimin qe ka pasur kur u inagurua eshte katandisur si mos me keq,trotuarin e bicikletave e kan mbytur ferrat mbeturinat pa pastruar,ne kete rruge kalojne me qindra turiste me biciklete cdo dite.			
15.1.2026		Pershendetje dhe uroj te jeni mir, un qe po ju kontaktoj jam bledar barreti nga fshati maminasi qarku dures, jam i interesuar nese mund ta mar kte informacion rreth ndonje projekti qe do zhvillohet nga maminasi autostrade direk per tek gjiri i lalzit nese ka nje projekt te tille ne kte zone nese mund te di sepse kam disa toka dhe doja te dija rreth keti projekti nese ka nje te tille nga ana juaj faleminderit dhe pune te mbare.	23.1.2026	Momentalisht Autoriteti Rrugor Shqiptar nuk ka ndonje projekt te ri rrugor qe lidh Maminasin me Gjirin e Lalezit	
22.1.2026		Prsh dritat rrugore lin_pogradec jane djegur me shume se gjysma 5 cop fikur 1 ndezur askush nuk interesohet ti rregulloje kaq e veshtire qenka per ti rregulluar,keta punonjesit qe e mirmabajne pse nuk i rregullojnë,eshte nje rruge qe krenohet shqiperia per ndriçimin qe ka pasur kur u inagurua eshte katandisur si mos me keq,trotuarin e bicikletave e kan mbytur ferrat mbeturinat pa pastruar,ne kete rruge kalojne me qindra turiste me biciklete cdo dite.	23.1.2026	Ne pergjigje te emailit te meposhtem, ju sqarojme si me poshte vijon: Ndriçimi I segmentit Lin - Pogradec eshte problematik per faktin se demtohet nga elemente keqberes vazhdimisht, me vjedhje kablli, demtim I leshuesave, automate te thyera, transformator I thyer e me pas I vjedhur e tjere. Nga ana e kompanise kontraktore te mirembajtjes eshte nderhyre vazhdimisht per keto demtime duke kryer riparimet me qellim mbajtjen ne funksion te tij.	

				Sapo jane evidentuar demtime nga ana e kompanise kontraktore jane bere edhe denoncime prane Prokurorise se Gjykates se Shkalles se Pare Korçe. Megjithate, nga ana jone perseri I eshte kerkuar qe kompania te ribeje nje inspektim per evidentimin e difekteve perseri dhe riparimin e tyre brenda kontrates aktuale te mirembajtjes, me qellim venien ne funksion te plote te ndriçimit. Bashkengjitur do te gjeni foto te demtimeve dhe foto nga nderhyrjet per riparime. Ndersa, persa i perket gjendjes se trotuareve te biçikletave ajo eshte nje investim I bashkise I cili nuk mirembahet nga ARRSH por nga bashkia.	
22.1.2026	Bazuar ne ligjin 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, Plani Kombëtar për Emergjencat Civile-Miratuar me VKM 807-datë 28.12.2023 dhe ligjin Nr.10 164, datë 15.10.2009 PËR AUTORITETIN RRUGOR SHQIPTAR, kerkojme marrjen e masave ne lidhje me shqetesimin e prefektit te Qarkut Shkoder. Me poshte do te gjeni e-mail te ardhur nga prefektura Shkoder, lidhur me dëmtimin e urës së ndodhur në vendin e quajtur “Përroi i Doganës”, Muriqan. Gjithashtu do te gjeni dhe location-in e ures se sipercituar. https://maps.app.goo.gl/F5zMaAPQfhjEjeis8?g_st=aw	26.1.2026	Lidhur me problemin e percjelle me emailin e meposhtem per dëmtimit e urës së ndodhur në vendin e quajtur “Përroi i Doganës”, Muriqan, siç ju sqaruar edhe me emailin e dates 23.01.2026, sqarojme si me poshte vijon: Edhe ne emilet e mepareshme lidhur me kete ankese, kemi sqaruar qe ura e lokalizuar ne vendin e quajtur "Perroi I Doganes", nuk eshte aset qe administrohet nga Autoriteti Rrugor Shqiptar pasi nuk lokalizohet ne aksin rrugor kombetar. Rruga kombetare Shkoder - Muriqan, sipas inventarit te miratuar me VKM Nr. 234, date 17.04.2024, pika fundore ku perfundon ky segment eshte ne piken me kordinatat 42°01'01.7" , 19°22'23.2" qe rakordon ne nje distance prej 70 m larg nga godina e doganes se Muriqanit. Ura ne fjale ndodhet ne zonen doganore qe nuk administrohet nga ARRSH.		

				Sa me siper, ARRSH nuk mund te nderhyje per riparimin e difekteve te aseteve qe jane jashte inventarit te saj.	
26.1.2026	<				

		pamundur → dhe përbën zvarritje administrative, jo kusht ligjor. 3 Rreth pretendimit për “likuidim vetëm mbi bazë dokumentesh hipotekore” Ky qëndrim është i gabuar juridikisht, pasi: ✓ shpronësimi e zhduk të drejtën e pronës ✓ ASHK nuk mund të lëshojë certifikatë për një pasuri të shpronësuar ✓ për rrjedhojë, dokumenti që kërkoni nuk ekziston më në sistem Ky fakt është konfirmuar edhe nga vetë ASHK. 4 KËRKESA JONË (PËRFUNDIMTARE) Në bazë të sa më sipër, kërkojmë: ✓ Zbatimin e menjëhershëm të VKM nr. 137/2023 ✓ Likuidimin e shumës që i takon secilit trashëgimtar ✓ Pa kërkuar dokumente që ligjërisht nuk mund të lëshohen Në të kundërt, do të detyrohemi të ndjekim: – rrugën gjyqësore për detyrim veprimi – kërkesë për dëmshpërblim për vonesë – kallëzim administrativ për moszbatim të aktit të Këshillit të Ministrave Me respekt, Shkëlqim Malevija ☎ 069 272 9460			
17.1.2026	Unë jam Dritan Kurti, gazetar në Qarkun Dibër. Bashkangjitur këtij e-maili do të gjeni një kërkesë për informacion!		27.1.2026	Në lidhje me kërkesën për informacion ju bëjmë me dije se: Kontrata e zbatimit të punimeve me objekt “Sistemim asfaltim rrugët e Rajonit Verior Shkodër” (Unaza Burrel) ka	

		Ju falenderoj paraprakisht për bashkëpunimin dhe ju uroj punë të mbarë!		përfunduar brenda afateve kontraktuale date 18.10.2025 dhe ende nuk ka përfunduar procesi i koaludimit. Projekti i zbatimit është hartuar nga Bashkia Mat. Autoriteti Rrugor Shqiptar ka kryer inspektime pas rreshqitjeve të ndodhura. Nga studimi gjeologjik i kryer nga një kompani e licencuar janë evidentuar disa plane rreshqitje të cilat variojnë nga 4m deri në 13 m, të cilat dalin jashtë parashikimeve të ndërhyrjes që kishte të parashikuar në projektin e zbatimit. Autoriteti Rrugor Shiptar po kryen një ekspertizë të thelluar situatës së krijuar dhe do të dalë me një zgjidhje tekniko–ekonomike për eliminimin e rrëshqitjeve dhe njëkohësisht garantimin e investimit të kryer.	
19.1.2026	Po ju drejtohem për të shprehur shqetësimin tim lidhur me informacionet që po qarkullojnë për kalimin e Bypass-it të Elbasanit përmes fushës së Labinot-Fushës, ndërkohë që punimet e Korridorit VIII po zhvillohen buzë lumit Shkumbin. Ky projekt, sipas të dhënave aktuale, prek disa banesa dhe toka bujqësore, ndërkohë që ekziston mundësia që e gjithë rruga të kalojë përgjatë lumit Shkumbin, ashtu siç po realizohet edhe Korridori VIII. Për ne këto janë pasuritë e vetme — shtëpia dhe toka — dhe çdo ndërhyrje do të kishte pasoja shumë të rënda sociale dhe ekonomike. Kërkoj një sqarim zyrtar nga institucioni juaj dhe rishikimin e kësaj trasesë, duke marrë parasysh interesin e komunitetit dhe minimizimin e dëmeve për banorët. Ju falënderoj për vëmendjen dhe pres përgjigjen tuaj. Me respekt, Reshit Koci	26.1.2026	Projekt ideja e objektit "Studim - Projektim ByPass Elbasan" është miratuar muajin Maj të vitit 2024, ndërsa projekti i zbatimit është miratuar në muajin Shtator 2025. Projektimi gjeometrik kushtezohet nga shumë kritere detyruese të Rregullit Teknik të Projektimit dhe Ndertimit të Rrugeve (VKM nr. 628, datë 15.7.2015), në përputhje me kategorinë e përzgjedhur të rrugës që në rastin e ByPass Elbasan është e kategorisë A. Kriteret e tilla si rrezja e kthesave, pjerresitë terthore dhe gjatësorët etj, lidhen ngushtë me shpejtësinë e projektuar të levizjes së mjeteve. Ndryshimi i tyre do të kërkonte rishikim të projektit të miratuar dhe të gjithë paketës shoqëruese. Për keto arsye, në këtë fazë, spostimi i gjurmës nuk është i mundur teknikisht dhe procedurialisht.		
29.1.2026	Unë, Xhevahir Ramazan Doka, me numër aplikimi MIE-2025-3497352-AS, ju drejtohem me këtë letër për të kërkuar				

		informacion mbi statusin e aplikimit tim për lejen e hyrje-daljes në rrugën nacionale Burrel–Klos. Ju lutem, nëse është e mundur, të më njoftoni në lidhje me përparimin e procesit të aplikimit. Për çdo informacion shtesë, mund të më kontaktoni në numrin tim të telefonit: 0683278042. Faleminderit për bashkëpunimin dhe kohën tuaj. Me respekt, Xhevahir Ramazan Doka			
	30.1.2026	Ju lutem shikoje pak rrugen nga kthesa e Patosit ne drejtim te Rroskovecit se eshte bere bere vec gropa. Na jane care gomat sa here bie shi hapen gropat qe ju i mbushmi me dy lopata asfalt.			
	1.2.2026	Ne aksin rrugor nacional Elbasan-Qafe Thane, prane Dragostunjes ka rene nje masiv i madh dheu, i cili ka bllokuar qarkullimin e automjeteve. Ne vendngjarje kane shkuar efektive te Drejtorise Vendore te Policise se qarkut Elbasan, te cilet po punojne per marrjen e masave te nevojshme dhe normalizimin e situates. Per sa me siper, te merren masa per hapjen e ketij aksi rrugor, pasi nuk ka rruge kalimi per automjetet.	2.2.2026	Rruga eshte hapur qe mbreme.	
	2.2.2026	Unë, Xhevahir Ramazan Doka, me numër aplikimi MIE-2025-3497352-AS, ju drejtohem me këtë letër për të kërkuar informacion mbi statusin e aplikimit tim për lejen e hyrje-daljes në rrugën nacionale Burrel–Klos. Ju lutem, nëse është e mundur, të më njoftoni në lidhje me përparimin e procesit të aplikimit . Për çdo informacion shtesë, mund të më kontaktoni në numrin tim të telefonit: 0683278042. Faleminderit për bashkëpunimin dhe kohën tuaj. Me respekt, Xhevahir Ramazan Doka			

22.1.2026	Unë quhem Xhesjana Senka, e diplomuar në Inxhinieri Naftë dhe Gaz dhe aktualisht ndjek studimet në Master Shkencor pranë Universitetit Politeknik të Tiranës. Dëshiroj të shpreh interesin tim për mundësi punësimi ose praktike profesionale pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARRSH), në profile të lidhura me sektorin teknik/infrastrukturor dhe procese të monitorimit/administrimit teknik. Ju bashkëngjis CV-në dhe vërtetimet e praktikave të kryera. Mbetem në dispozicion për çdo informacion shtesë dhe do të isha e interesuar për një mundësi takimi/interviste, nëse profili im përputhet me nevojat e institucionit. Ju lutem, nëse është e mundur, ta përcillni këtë email pranë departamentit/personave që merren me rekrutimin.	2.2.2026	Ne pergjigje te email ku shpreheni interesin tuaj per mundesi punesimi ose praktike ne Autoritetin Rrugor Shqiptar, ju lutemi referohuni ne shpallje ne pozicionet vakante ne faqen zyrtare te institucionit.	
19.1.2026	Po ju drejtohem për të shprehur shqetësimin tim lidhur me informacionet që po qarkullojnë për kalimin e Bypass-it të Elbasanit përmes fushës së Labinot-Fushës, ndërkohë që punimet e Korridorit VIII po zhvillohen buzë lumit Shkumbin. Ky projekt, sipas të dhënave aktuale, prek disa banesa dhe toka bujqësore, ndërkohë që ekziston mundësia që e gjithë rruga të kalojë përgjatë lumit Shkumbin, ashtu siç po realizohet edhe Korridori VIII. Për ne këto janë pasuritë e vetme — shtëpia dhe toka — dhe çdo ndërhyrje do të kishte pasoja shumë të rënda sociale dhe ekonomike. Kërkoj një sqarim zyrtar nga institucioni juaj dhe rishikimin e kësaj trasesë, duke marrë parasysh interesin e komunitetit dhe minimizimin e dëmeve për banorët. Ju falënderoj për vëmendjen dhe pres përgjigjen tuaj. Me respekt, Reshit Koci	2.2.2026	Qytetari eshte i mirepritur prane zyrave te institucionit per sqarime shteruese	
5.2.2026	Pershendetje do doja te dija nese ne oren 03 :00 pra ne mengjes heret dates 06-02-2026 a eshte hapur rruga Perrenjas-Librazhd a mund te kaloj pasi kam avionin heret.	5.2.2026	Edhe sonte nga ora 22 deri ne oren 05 te mengjesin te dates 06.02.2026 rruga do jete e mbllokuar. Çdo tentativë tjetër mund të jetë me risk për t'u vonuar.	
4.2.2026	Unë jam Rosela Çejku, studente dhe punoj pranë A2 CNN. Po realizoj një investigim mbi bllokimin e monopatinave elektrike	5.2.2026	Lidhur me kerkesen e meposhteme sjelle nga studentja Rosela Çejku, sqarojme se:	

		dhe ju drejtohem për të kërkuar informacion zyrtar mbi bazën ligjore dhe procedurat e ndjekura për këtë vendim në bazë të ligjit për të drejtën e informimit, Ligji nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i miratuar më 18.09.2014, garanton të drejtën e çdo personi për t’u informuar mbi informacionin publik që zotërohet nga autoritetet publike. Informacioni do të përdoret për qëllime investiguese dhe informim publik. Ju falënderoj paraprakisht dhe mbetem në pritje të përgjigjes suaj.		Autoriteti Rrugor Shqiptar administron rrugët nderqytetese të cilat nuk kanë korsi të dedikuar për monopatina. Keto kërkesa lidhen me zonën brenda qyteteve dhe kërkesa duhet të drejtohet bashkëve që administrojnë rrugët brenda qyteteve. Ndersa lidhur me pyetjet për bllokimet e qarkullimit të skuterave janë të dhëna që mund të merren nga Policia Rrugore. ARRSH nuk disponon asnjë nga të dhënat e kërkuara.	
5.2.2026	Cilat masa afatshkurtra dhe afatgjata po merren për të parandaluar rrëshqitje të ngjashme në të ardhmen në këtë segment rrugor? Sa kohë pritet që punimet për pastrimin dhe stabilizimin e masivit të përfundojnë dhe të lirohet plotësisht rruga për të dyja korsitë? Cili është shkaku kryesor i rrëshqitjes së masivit dhe a ka ndonjë lidhje kjo me punimet e Korridorit 8? Esmeralda Topi	5.2.2026	<i>Ne këtë segment rrugor dhe në të gjitha segmentet rrugore që administrohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, janë në fuqi kontratat perkatese për mirëmbajtjen e këtyre segmenteve rrugore të cilat kanë të parashikuar edhe fond emergjence. Punimet për pastrimin dhe stabilizimin të masivit, për të liruar plotësisht rrugën në të dyja korsitë do të përfundojnë brenda tre ditësh. Jemi të mendimit se shkaku kryesor i rrëshqitjes së masivit është prezenca e shtuar e ujërave sipërfaqesore dhe nentokesore, si pasojë e rrëshjeve të shumta në një kohë të shkurtër. Gjithashtu mund të themi se situata e krijuar nuk ka ndonjë lidhje me punimet e Korridorit 8.</i>		
9.2.2026	Pershendetje jam banori i fshatit Vishaj Tirane. Firma që ndjek punimet nuk bën murin mbajtës që është një problem i madh si për mua që kam pronën dhe për gjithë lagjen. Se po nuk u more një masë për firmën që të bëjë murin se shpejtë ka me ndodh aksiden se është me këthese dhe shumë e rrezikshme. Ju lutem mereni në konsideratë se akoma është firma punuese. Po pres një përgjigje.	10.2.2026	Sic evidentohet edhe nga tabela e punimeve kjo është një investim që nuk ka lidhje me ARRSH.		

9.2.2026	Unë, Saimir Mece, me vendlindje fshati Memaliaj, adresa rruga manxhar skendo nr 09, kam paraqitur prej vitesh kërkesa për hapjen e rrugës së emergjencës, e cila është miratuar disa herë nga Këshilli Bashkiak i Bashkisë Memaliaj, si dhe nga Prefektura, me vendim zyrtar Këshilli, vendim gjykatë dhe shkresë zyrtare VKM (mutacion) nga ish-Prefekti i Gjirokastrës. Urbanistika ka kryer piketimet përkatëse dhe rruga është hapur, por jo në mënyrë të plotë, pasi aktualisht ekzistojnë pengesa të pajustificuara. Këto pengesa nuk i shkaktojnë asnjë dëm apo pengesë fqinjëve dhe bien ndesh me vendimet e miratuara nga institucionet përkatëse. Kam dorëzuar kërkesë edhe në platformën e-Albania dhe pres përgjigje zyrtare. Dua të theksoj se zvarritja e këtij procesi ka vite që vazhdon dhe më ka shkaktuar shpenzime të shumta dhe padrejtësi të vazhdueshme, pavarësisht faktit që kam të drejtë ligjore për hapjen e kësaj rruge emergjence. Pasi ka nje perkujtimore te nje personi qe grabiste refugjatet dhe ka humbur jeten aty bllokoi rrugen kryesore... personi nuk eshte banor i zones eshte nga Pogradeci... po ju bashkangjis foto edhe te fqinjit tjeter ku behet fjale per 20 cm qe te futet edhe dali zjarrefiksja nuk eshte se u pengon gje fqinjeve edhe pse piketimet nga urbanistika eshte me shume sesa ne kerkojne per lirimin e emergjences.. sic e shikoni futej makina e madhe tani mezi futet nje ambulance eshte ber shtese punime nga fqinjet pa leje pasi une jetoj jashte shtetit e vellai eshte i semure e nuk i ndjek dot ceshtjet.. Kërkoj Që çështja të merret në konsideratë dhe vendimet ekzistuese të zbatohen pa vonesa të mëtejshme, duke i dërguar shkresën përkatëse Bashkisë Memaliaj dhe Urbanistikës, si dhe, nëse është e nevojshme, edhe IKMT-së për zbatim. Pasi	10.2.2026	Ne pergjigje te ankeses se ardhur nga Z. Saimir Meçe lidhur me ndertimin e nje rruge emergjente, sqarojme se rruget e fshatit Memaliaj nuk bejne pjese ne inventarin e rrjetit rrugor kombetar qe administrohet nga Autoriteti Rrugor Shqiptar. Per kete arsye nuk mund te nderhyjme per zgjidhjen e ankeses se banorit.	
----------	---	-----------	---	--

		Bashkëlidhur po paraqes të gjitha materialet dhe vendimet zyrtare të aprovuara. Në këtë rast kërkohet vetëm zbatimi i vendimeve ekzistuese dhe jo miratim i ri. Nëse kjo kërkesë nuk merr zgjidhje, do të detyrohem t’i drejtohem instancave më të larta shtetërore. Me miqesite qe kam do ja nis Kryeministrit si dhe kanaleve televizive. What’s app numer 0697711700 pasi jetoj jashte shtetit. Pres nje pergjigje nga ju Me respekt, Saimir Mece			
11.2.2026	Ju shkruaj per te sjelle ne vemendjen tuaj nje problem shqetesues lidhur me mirembajtjen e rrugeve ne autostraden Unaza e Veriut. Prej me shume se 2 muajsh kam vene re pranine e disa kafsheve te ngordhura (qen dhe mace), te cilet gjenden ne ane te rruges. Kjo situate krijon nje pamje vertet te pakendshme si dhe perben rrezik per sigurine e drejtuesve te mjeteve. Dekompozimi i kafsheve te ngordhura shkakton ere te keqe dhe cliron baktere duke rezultuar ne perhapje te patogjeneve dhe mbledhje te mbeturinave. Ju lutem te ndermerrni masa per pastrimin dhe mirembajtjen e rregullt te autostradave, me qellim ruajtjen e higjienes se infrastrukures rrugore. Nje reagim i shpejte nga ju do te tregoje kujdesin e institucioneve per mireqenien e qytetareve. Faleminderit per vemendjen dhe kohen tuaj! Me respekt, Emi Cenka	11.2.2026	Lotet e Unazes nuk jane ne mirembajtjen tone pasi I kane kaluar Bashkise Tirane. Po e dergojme prane Bashkise Tirane per ta trajtuar.		
2.2.2026	Jam Mimoza Stema ,drejtore e shkollës 9-vjeçare "Hajdar Hoxha" Larushk. Po ju paraqes më poshtë kërkesën time si drejtuese e kësaj shkkolle në lidhje me sigurinë rrugore të komunitetit të nxënësve dhe stafit mësimor të shkollës sonë.	10.2.2026	Ne pergjigje te ankeses se ardhur nga drejtoria e shkolles 9-vjeçare “ Hajdar Hoxha”Larushk e cila ndodhet buzë rrugës nacionale Tiranë – Fushë Krujë, nga ana e kompanise kontraktore te mirembajtjes, eshte nderhyre per marrjen e masave per rifreskimin dhe plotesimin me sinjalistiken e duhur vertikale dhe horizontale.		

				Kjo kerkese ka ardhur edhe ne forme shkresore, pergjigjen e se ciles e gjeni bashkengjitur. Gjithashtu, gjeni bashkengjitur foto nga sinjalistika e instaluar.	
2.2. 2026	Po punoj për një kronikë lajmesh për ecurinë e punimeve në Tiranë-Durrës dhe në rrugën e Ndroqit dhe për realizimin e saj, kërkoj informacion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar për pikat si më poshtë vijojnë: -Në çfarë faze janë aktualisht punimet për Tiranë-Durrës dhe në rrugën e Ndroqit? -Për rrugën Tiranë-Durrës u deklarua se do të hapej për qarkullim në dhjetor e më pas në janar, por diçka e tillë ende nuk ka ndodhur. Pse është vonuar hapja e segmentit ku po punohet? -Kur do të jetë ai i aksesueshëm nga përdoruesit e rrugës pa kufizim për punime? -Po punimet në rrugën e Ndroqit si po ecin? Kur do të përfundojë loti i parë? -Cilat janë fazat e tjera të punimeve për Tiranë-Durrës dhe rrugën e Ndroqit? Në cilat lote do të punohet? -A janë tenderuar lotet e tjera? -A ka pengesa në terren për dorëzimin e projekteve në kohë? Në pritje, Mimoza Ibra Vizion Plus TV	24.10.2025			

27.1.2026	Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Ligjit nr. 119/2014 për të drejtën e informimit, kërkoj, dokumentacionin e plotë lidhur me projektin e ndërtimit të Unazës së Brendshme dhe Unazës së Jashtme të Tiranës, përkatësisht dokumentet publike si në vijim: 1. Të gjitha dokumentet e këtij projekti (vendimet, planifikimet, shpronësimet, tenderimet, prokurimet publike, të tjera); 2. Procesverbalet e konsultimeve publike të zhvilluara për këtë projekt; 3. Të gjitha kontratat e lidhura dhe anekset evetuale të tyre, objekt i së cilave është ky projekt; 4. Të gjitha burimet e financimit, buxhetit të këtij projekti; dhe 5. Hartat (dhe ato kadastrale) para dhe pas ndërtimit të unazave. Në pritje të përgjigjes suaj dhe pranimi të këtyre dokumenteve publike sipas afatit të përcaktuar ligjor, kërkoj që të njejtat (të gjitha) të më vihen në dispozicion në format elektronik në këtë e-mail: fatlum.sylejmani@student.uni-pr.edu. Faleminderit për mirëkuptim, Fatlum Sylejmani,	13.2.2026	Bashkelidhur do te gjeni VKM-te perkatese per segmentin rrugor "Unaza e Madhe Tirane".	
15.2.2026	Në mbështetje të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ju lutem të më vini në dispozicion dokumentacionin zyrtar të miratuar që lidhet me projektin “Bypass i Tiranës”.			

		Konkretisht, kërkoj: • planin rrugor të aprovuar (trase), • hartat orientuese dhe/ose situacionale, • përfshirë segmentet Kashar–Vaqarr dhe vijimet përkatëse të projektit. Ju lutem që informacioni të përcillet në format elektronik (PDF), nëse është e mundur. Faleminderit për bashkëpunimin dhe mbetem në pritje të përgjigjes suaj brenda afateve ligjore. Me respekt, Ergis Benja			
16.2.2026		Kurë do të vijë ajo ditë që Ju si ARRSH do ti ktheni sytë edhe tek Aksi Kombëtar Skuraj-Burrel?Ky ask tejet i rëndësishëm për Qarkun Dibër është katandisur si mos më keq.Dëmtimi i këtij aksi në përgjithësi dhe sidomos në shtresën asfaltike ka penalizuar një zonë të tërë ku jetojnë me mijra banorë.Pastaj është edhe problemi i urave dhe sidomos i urës së Karicës që jan bërë tejet të rrezikshme për qarkullimin e automjeteve!			
18.2.2026		Ju lutem a mund ta shikoni pak kte aksin se na jane bere makinat copa nga gropat dhe vizat qe jane hapur ne rruge, sidomos nga kthesa e Patosit deri ne Roskovec. Nje shi bie dhe hapen gropat behen te pakalueshme.			

19.2.2026	Bashkëlidhur po ju dërgoj shkresën time zyrtare, datë 19.02.2026, në lidhje me: – gjendjen e banesës sime, – aksesin në pronë, – dhe statusin e dorëzimit të projektit “Unaza e Madhe e Tiranës”. Bashkëlidhur gjeni gjithashtu dokumentacionin fotografik dhe referencat përkatëse të përmendura në shkresë. Në pritje të një përgjigjeje të arsyetuar brenda afatit ligjor, në përputhje me Ligjin nr. 119/2014 ‘Për të drejtën e informimit’ dhe Kodin e Procedurave Administrative. Me respekt, -- Ferid Kolbucaj			
19.2.2026	Jam i interesuar te marr informacion nga ju per nje vendim te nje ceshtje gjyqesore e cila ka perfunduar si ceshtje ne Gjykatën tuaj me Gjyqtar Z.Marko Boshku dhe u be shume kohe e gjate qe ne tetor 2025 qe presim vendimin ne leter. Çeshtja eshte ne emer te mamase time Suzana Gjuzi, pale paditese Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjensia Shqiptare e Shpronesimit etj, me titullin pavlefshmeri akti. Ju lutem te na ktheni nje pergjigje ne lidhje me dorezimin e ketij vendimi.			
20.2.2026	Po ju drejtohem me shumë respekt dhe me një shqetësim të thellë në emër të banorëve të zonës Qafë Prush – Zogaj dhe fshatrave përreth, për gjendjen jashtëzakonisht të rëndë të rrugës kryesore që lidh këtë komunitet me Tropojën, Hasin dhe më tej me Gjakovën (Kosovë). Kjo rrugë është jetike për qindra familje dhe disa fshatra që varen plotësisht prej saj për lëvizjen e përditshme, për transportin e të sëmurëve, për shkollimin e fëmijëve dhe për			

	aktivitetet ekonomike. Megjithatë, realiteti sot është shumë i dhimbshëm: rruga ndodhet në një gjendje ekstreme amortizimi, me gropa të mëdha, gurë, baltë dhe dëmtime të rënda që e bëjnë kalimin pothuajse të pamundur, sidomos gjatë dimrit dhe reshjeve. Automjetet e vogla shpesh nuk mund të kalojnë fare, ndërsa edhe mjetet e larta detyrohen të lëvizin me shumë vështirësi dhe rrezik. Ajo që e bën situatën edhe më të rëndë është fakti se kjo rrugë ka mbi 30 vite që ka mbetur pa investime serioze — praktikisht që nga periudha para viteve '90 nuk është bërë asnjë ndërhyrje e plotë për asfaltim apo rehabilitim. Komuniteti këtu ndjen se është harruar, megjithëse bëhet fjalë për një aks kryesor lidhës ndërmjet zonave dhe me rëndësi edhe për lidhjen me Kosovën. Me shumë përlësi dhe shpresë, dëshirojmë t'ju kërkojmë nëse do të ishte e mundur që nga ana juaj të organizohej një verifikim në terren nga specialistët përkatës dhe të merrej në konsideratë mundësia e ndërhyrjes për rehabilitimin dhe asfaltimin e kësaj rruge. Për banorët e kësaj zone, një hap i tillë do të kishte një ndikim të jashtëzakonshëm në jetën e përditshme dhe në sigurinë e tyre. Ne nuk po kërkojmë luks — po kërkojmë mundësinë minimale për të jetuar me dinjitet dhe për të pasur një rrugë të kalueshme që lidh komunitetin tonë me pjesën tjetër të vendit. Ju falënderojmë sinqerisht për kohën dhe vëmendjen tuaj dhe shpresojmë shumë që zëri ynë të dëgjohet. Me respekt të thellë, Dilaver Aliaj			
--	--	--	--	--

26. 2.2026	Kerkese per vendosje sinjalistike			
21.2.2026	Me ane te ketij emaili "A.N.K" sh.p.k. Ju ve ne dijeni lidhur me situaten e krijuar ne aksin nacional ekzistues Elbasan - Pogradec ne lidhje me linjat e tensionit te larte te linjes 110 kV ne afersi te rruges. Gjate diteve te meparshme jane konstatuar rreshqitje dheu dhe te rruges ne kete aks, te cilat tashme jane shfaqur edhe ne shtyllen me Nr L110 - 16/3a, 15/74 . Verehen carje te dheut mbi Bazamentin e shtylles ne fjale. Bashkangjitur foto nga situata ne fjale dhe pozicioni I shtylles ne fjale ne Google Maps. Lutemi nga ana juaj te merrni masa sa me shpejt te jete e mundur. Pozicioni I shtylles ne fjale ne Google Maps. https://maps.app.goo.gl/rkUTpPuoidAoVWJY9 Me respekt, "A.N.K" sh.p.k.			
21.2. 2026	A mund te kem nje info rreth bypasit qe do te krijohet? (Librazhd-Elbasan) Rreth cfare ore mund ta aksesojne autoveturat?	21.2.2026	Informacion rreth Bypasit qe do krijohet Punimet per bypass-in provizor kane filluar qe gjate dites se sotme dhe jane ne vazhdim. Edhe gjate dites se neserme do	

		Kemi ngel ne qytetin e Korce prej dites sotme te njoftimit tuaj.		punohet me intensitet qe gjithsesi do te varet edhe nga situata. Deri ne zgjidhjen e situates aset alternative jane: ✓Maliq-Lozhan-Strelc-Gramsh-Elbasan ✓Qafthana-Pogradec -Korca - Leskovik -Permet -Tepelene. ✓Kurse aksi tjetër për qarkullim trafiku (duke përfshirë kryesisht mjetet e tonazhit) është pika doganore Q.Thane-Maqedoni-pika Doganore e Bllates - Rr. e Arberit.	
22.2.2026	Unë që po ju shkruaj jam një drejtues mjeti që aktualisht ndodhem në segmentin Qafë Thanë – Elbasan. Gjatë rrugës jemi njoftuar se aksi kryesor është i bllokuar dhe po na udhëzojnë të ndjekim rrugën alternative nga Hotolishti, Dardha dhe Spathari . Ju lutem, a mund të na konfirmoni zyrtarisht: 1. Pse është bllokuar aksi kryesor dhe sa parashikohet të zgjasë ky bllokim? 2. A është rruga alternative (Hotolisht-Dardhë-Spathar) e sigurt dhe e kalueshme për të gjitha llojet e mjeteve në këto momente? 3. A ka prezencë të policisë apo sinjalistikës orientuese në këtë segment? Mbetem në pritje të një përgjigjeje të shpejtë për të garantuar sigurinë e udhëtimit tonë.	22.2.2026	Kthim përgjigje / Kerkese informacioni ARRSH sygjeron si aks alternativ: ✓Maliq-Lozhan-Strelc-Gramsh-Elbasan ✓Qafthana-Pogradec -Korca - Leskovik -Permet - Tepelene. ✓Kurse aksi tjetër për qarkullim trafiku (duke përfshirë kryesisht mjetet e tonazhit) është pika doganore Q.Thane-Maqedoni-pika Doganore e Bllates - Rr. e Arberit.		
23.2.2026	Unë, Vere Frrok Tusha edhe Prende Frrok Ndoja , pronaret e pasurisë private nr. 185/85 dhe nr. 185/84 , në zonën kadastrale nr. 1495, me adresë Shkodër – Dobraq, paraqes këtë kërkesë në lidhje me procedurën e shpronësimit për projektin “By Pass Perëndimor Shkodër”. Kërkoj që çdo vlerësim i kryer ose që do të kryhet për këto pasuri të jetë i drejtë, i argumentuar dhe i dokumentuar, në përputhje me Ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për				

	shpronësimet për interes publik” dhe VKM nr. 89, datë 03.02.2016. Nga verifikimi i gjendjes faktike të pasurisë rezulton se duhet të merren në konsideratë: • Gjendja reale e tokës; • Investimet dhe përmirësimet e kryera në pasuri; • Vlera aktuale e tregut në zonë; • Dokumentacioni i plotë i pronësisë, i cili bashkëngjitet. Për sa më sipër, kërkoj rishikimin e vlerësimit dhe transparencë të plotë mbi kriteret dhe metodologjinë e përdorur për përcaktimin e kompensimit. Gjithashtu, kërkoj të më vihet në dispozicion dokumentacioni i plotë administrativ që lidhet me këtë procedurë, përfshirë aktet përkatëse, procesverbalet dhe çdo dokument tjetër që provon respektimin e procedurave ligjore. Ju lutem të më njoftoni me shkrim për: • Numrin e protokollit të kësaj kërkesë • Procedurën e mëtejshme të shqyrtimit • Konfirmimin nëse pronarët aktualë janë përfshirë zyrtarisht në proces. Me respekt, Vere Tusha			
21.2.2026	Dua të paraqes një ankesë në këtë email për shkatërrimin e rrugës në fshatin Tagan, Tiranë, pasi platforma Rruga Dixhitale nuk funksionon. Është një rrugë që nuk ka shumë kohe që është ndërtuar dhe është prishur tashmë prej kamionave të shumtë që kalojnë në atë zonë. Dëmtimet variojnë që nga gropat në asfalt e deri në shkatërrimin e kanalit vaditës të rrugës, kjo për shkak të rrëzimit dhe kalimit të kamionave afër buzës së kanalit. Bashkangjitur mund të gjeni fotot me dëmtime të rrugës.	23.2.2026	Ne pergjigje te ankeses se meposhtme lidhur me shkaterrimin e rruges se fshatit Tagan, sqarojme se rruga ne fjale nuk ben pjese ne inventarin e rrjetit rrugor kombetar qe administrohet nga ARRS. Po e delegojme prane pushtetit vendor dhe fshzh.	

23.2.2026	Pershendetje quhem Dorina Ndoka, nga qyteti i Lezhes, jam ne faze procedure pranw ASHK-se , Drejtoria Vendore Lezhe, dhe per efekt procedure ashk i eshte drejtuar institucionit tuaj per informacion me shkresen me nr.317/1 Prot, date 27.01.2026 , ku kerkojn vendimin e shpronesimit me nr.246, date 24.04.2003, ku ka perfituar Z.Zef Gjergj Ndoci, subjekt perfitues nga shpronesimi i projektit te superstrades Lezhe-Shkoder, se bashku me skicen ne menyre qe te vazhdojne me proceduren ligjore. Ju lutem kerkojm bashkepunimin tuaj per kthimin e pergjigjes nga ana juaj ! nr.tel 0698489026			
23.2.2026	Duke qene SE nesor kam nje udhetim per ne Struge do me ndihmonit me nje info nese aksi Librazh Prenjas do jete I lirshem per qarkullimin rrugor Faleminderit	23.2.2026	Aksi Librazhd Prenjas vazhdon te jete i bllokuar. Ju lutem ndiqni rruget alternative te njoftuara nga ARRSH.	
25.2.2026	Bl. po ju dërgojmë shkresën e Këshillit të Ministrave e cila përcjell kërkesën e Bashkisë Shkodër qe adreson nevojën për ndërhyrje emergjente tek Ura Bardhaj, Njësia Administrative Rrethina, Shkodër, kërkesë e cila është drejtuar për Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile ku MIE është në dijeni. Problematika te vlerësohet brenda fushës se përgjegjësisë së ARRSH-së.	26.2.2026	Ne vijim te kerkeses se meposhteme sqarojme se: Ura e Bardhajve nuk ben pjese ne asetet qe menaxhohen nga ARRSH, pasi lokalizohet ne nje rruge qe nuk eshte ne inventarin e rrjetit rrugor kombetar qe administrohet nga ARRSH.	

	27.2.2026	Prokuroria pranë Gjykatës se pare te Juridiksionit te Pergjithshem Fier me anë të një shkrese nr. 15286 Prot., date 19.12.2025 (bashkëlidhur) kërkon informacion për nevoja hetimi te një procedimi penal mbi përcaktimin e kategorisë së rrugës dhe kufizimet e shpejtësisë të segmentit rrugor "Marinëz-Suk 1", vendndodhje lagjja "Agaçaj", fshati Suk 1, njësia administrative Strum, bashkia Roskovec, qarku Fier. Lutemi, pas verifikimeve dhe brenda fushës së përgjegjësisë të institucionit, ktheni përgjigje për prokurorinë në respektim të afatit kohor të kërkuar.			
	28.2.2026	Pershendetje dhe pergezime per punen qe po vazhdoni ne aksin problematik te Dragostunjes. Ju lutesha nje pyetje si nje qytetar ose subjekt me sakte ku operon me mjetet e renda. A do te jete i kalueshem aksi alternativ ose emergjent per mjetet e tinazhit te rende? (Trailera)	1.3.2026	Ne momentin e venies ne funksion te rruges alternative po, do te jete e aksesueshme edhe per mjetet e tonazhit te rende.	
	1.3.2026	Duhet te marr nje vendim, nese mund te marr pjese ne nje feste ne qytetin tim. Duhet te vij nga Italia me daten 7 e te jem ne Korce brenda ores 6. Me intereson te di a do te arrihet te udhetohet normalisht nga rruga normale ate dite apo do te jete perseri rruga e vjeter, e cila sic me ka informuar shoferi eshte shume problematike, mua me shqeteson dhe makina. Ne baze te pergjigjes suaj do te marr dhe nje vendim.	1.3.2026	Rruget e ofruara alternative aksesohen pa problem, vetem koha eshte pak me e gjate. Gjithsesi ndiqni vazhdimisht njoftimet tona nese diçka ndryshon.	
	3.3.2026	Ju lutem te thoni, sa km.apo sa m. eshte ky segment provizor i juglindjes,qe te dime si te veprojme.	17.3.2026	Ne pergjigje te e-mailit te dates 02 mars 2026, sipas shkreses nr. 15786 prot date 19.12.2025, te Prokurorise	

				prane Gjykates se Shkalles se Pare Fier ju bejme me dije se: Segmenti rrugor Strum - Marinez, eshte pjese e inventarit te rrjetit rrugor kombetar, ne zbatim te VKM Nr. 234, date 17.04.2024. Ai mbulohet me sherbimin e mirembajtjes, sipas kontrates se lidhur nga Drejtoria e Rajonit Jugor Gjirokaster. Lidhur me kerkesat e parashtruara per kete segment rrugor, po ju veme ne dispozicion informacionin e meposhtem: 1. Bazuar ne VKM nr. 234 date 17.04.2024: "Per disa ndryshime ne VKM nr. 600 date 13.10.2021 "Per pronesine e rrugeve shteterore dhe kalimet e pronesise ndermjet enteve pronare te rrugeve", aksi rrugor Strum – Qafe Marinez ku perfshihet segmenti Marinez – Suk 1 eshte rruge e kategorise "F". 2. Bashkengjitur do te gjeni fotot e derguara nga supervizori I kontrates se mirembajtjes ku perfshihet segmenti rrugor Strum - Marinez, ne te cilat tregohet sinjalizimi per kufirin e shpejtesise ne zonen e lagjes "Agacaj", fshati Suk 1, Njesia Administrative Strum, Bashkia Roskovec.	
2.3.2026	Une jam Xhesika Tollia gazetare e Rrejtit per Raportimin Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit në Shqipëri, (Organized Crime and Corruption Reporting Project in Albania), dhe uroj të gëzoni shëndet të mirë.		3.3.2026	<i>Pjesa Librazhd – Prrenjas është mbuluar rregullisht me mirëmbajtje rutinë deri me datë 6 shkurt 2026, kur segmenti u zbrit nga kontrata e mirëmbajtjes pasi</i>	

	Do ju lutesha të kem bashkëpunimin tuaj në lidhje me një ceshtje të cilën ne mendojmë se është në interes publik. Në dokumentin atach, janë përmbledhur kërkesat tona për të cilat lusim bashkëpunimin tuaj. Me respekt, Xhesika Tollia		<i>shërbente si rrugë kantieri për projektin e ri. Janë kryer inspektime të vazhdueshme pasi kanë qënë pjesë e kontrates së mirëmbajtje dhe eshte detyrim qe permban kjo kontrate. Këto inspektime gjenerojnë përherë më një raport mujor që përgatitet nga mbikëqyrësi. Jo nuk ka patur problematika të tilla paraprakisht pasi do të ndërhyej menjëherë. Kufiri i lumit Shkumbin nuk ka qenë pranë trupit të rrugës, por pranë trasesë së linjës hekurudhore.</i>	
6.3.2026	Rruga ne Himarë fshat eshte me gropa edhe perben rezik per kalimtarete sepse makinat manovrojne tek gropat.Gjithastu rruga eshte prere per te kaluar ujrat e zeza po nuk eshte asfaltuar mire do rimbushje. Po ju dergoj fotografi te cilat derguam tek firma Sallilari po duan nga ju aprovim qe te veprojne. Me mirekuptim cel.0697994523.			
7.3.2026	Jam Altin Mucaj, doja te pyesja se kur fillojn punimet ne rrugen Patos -Fier. Kam token ne ane te ruges e doja te filloja nje investim.Nuk e di a me prek rruga e re.			
7.3.2026	Unë, Erlini Qordja, banor në fshatin Ibe e Poshtme, pranë segmentit të autostradës Tiranë–Elbasan, ju drejtohem për të paraqitur një shqetësim serioz lidhur me zhurmën e vazhdueshme që shkaktohet nga trafiku i automjeteve në këtë aks rrugor.Prej kohësh, zhurma e automjeteve është bërë shumë e bezdisshme për banorët e zonës, sidomos gjatë orëve të pikut të trafikut dhe në mbrëmje. Në përpjekje për të vlerësuar situatën, kam kryer matje orientuese të nivelit të zhurmës me pajisje celulare profesionale, ku rezulton se niveli mesatar arrin 82–84 dB(A), ndërsa vlerat maksimale shkojnë deri në 90 dB(A) dhe shpesh ne raste shpejtesie te larte e kalojne vleren 110 dB(A). Kuota e autostades ne raport me shtepite e banimit, eshte me e larte, bimesia mungon, dhe kjo ben qe pikerisht ne kete segment ky problem te jet me i theksuar. Fshati Ibe e Poshtme dhe Pellumbas qe preken nga ky shqetesim kane			

	atraksione turistike si Shpella e Pellumbasit. Lumi Erzen etj. te cilat vizitohen nga turiste vendas dhe te huaj cdo dite dhe ky eshte nje shqetesim dhe per to pasi nuk gjejne ketu ate qe kerkojne, qetesine e nje zone rurale te gjelberuar .Ky eshte nje shqetesim i cili prek me shume se 1200 banore rezidente te kesaj zone. (Fotografite e matjeve bashkelidhen me kete kerkesë.)Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 435, datë 12.09.2018, dhe Direktivës Europiane 2002/49/EC, niveli i lejuar i zhurmës në zonat pranë rrugëve kryesore nuk duhet të kalojë:· 65 dB(A) gjatë ditës, · 55 dB(A) gjatë natës. Pra, matjet e kryera tregojnë një tejkalim të ndjeshëm të kufijve ligjorë, çka përbën ndotje akustike dhe ndikon negativisht në cilësinë e jetesës së banorëve.Duke qenë se kam formim profesional në fushën e inxhinierisë së ndërtimit dhe njohuri mbi mbrojtjen akustike të mjedisit, sugjeroj që në këtë segment të autostradës të vendosen barrierat akustike në anë të rrugës, në një gjatësi prej rreth 800 metra, sic tregon edhe skica, në përputhje me standardet bashkëkohore të mbrojtjes së mjedisit urban. Personalisht e vlerësoj shumë të vlefshëm një investim të tillë, duke qenë se komuniteti mund të jepet një zgjidhje me një investim modest.Së bashku me këtë kerkesë, bashkelidh edhe një skicë orientuese ku propozoj pozicionimin e këtyre barrierave. Duke ju falënderuar për vëmendjen dhe për angazhimin tuaj në përmirësimin e infrastrukturës rrugore dhe jetesës së qytetarëve, mbetem në pritje të një përgjigjeje dhe veprimi konkret për këtë problem.			
3.3.2026	Ju lutem te thoni, sa km.apo sa m. eshte ky segment provizor i juglindjes, qe te dime si te veprojme.	3.3.2026		
4.3.2026	Pranë Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA) është paraqitur një kërkesë nga një subjekt i interesuar për realizimin e një investimi në Republikën e Shqipërisë, në kuadër të Ligjit nr. 55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”. Subjekti në fjalë ka shprehur interes për zhvillimin e një zone në Bashkinë Vlorë dhe në funksion të përgatitjes së			

	masterplanit për zhvillimin e sipërfaqes, kërkon disa të dhëna teknike që i konsideron të domosdoshme për përgatitjen e masterplanit të detajuar të zonës së synuar për zhvillim. Bashkëlidhur këtij emaili gjeni hartën përkatëse të zonës së interesit. Ju lutemi të na vini në dispozicion, informacionin e mëposhtëm për zonën e specifikuar: Të dhëna mbi infrastrukturën rrugore ekzistuese, konkretisht shpërndarjen e rrugëve sipas volumit aktual të trafikut dhe llojeve të automjeteve (autovetura, mjete transporti mallrash, transport publik, etj.) në segmentet rrugore që kalojnë ose lidhen me zonën e projektit. Informacion mbi qarkullimin në nyjet ekzistuese, të dhëna mbi trafikun në kryqëzime, rrethrrrotullime dhe hyrje-dalje në rrugë interurbane brenda zonës së referuar, si dhe çdo studim trafiku që mund të jetë i disponueshëm. Të dhëna mbi projektet infrastrukturore të planifikuara ose në proces, në kompetencë të ARRSH, që lidhen me ndërtimin, zgjerimin apo përmirësimin e rrugëve në këtë zonë, duke përfshirë edhe kornizën kohore të parashikuar të zbatimit nëse informacioni ekziston. Lutem të mbani parashysh që informacioni të përfshijë segmentet rrugore që kalojnë ose lidhen me zonën e projektit.			
3.3.2026	Ne jemi gazetarë nga Rrjeti për Raportimin e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit të cilët po punojmë në lidhje me një cikël shkrimesh për akset rrugore në Shqipëri. Gjatë shqyrtimit të informacioneve na kanë lindur disa pyetje për të cilat do të luteshim të kishim komentin tuaj në mënyrë që raportimi jonë të jetë sa më i saktë dhe afër së vërtetës.	4.3.2026	Pjesa Librazhd – Prrenjas është mbuluar rregullisht me mirëmbajtje rutinë deri me datë 6 shkurt 2026, kur segmenti u zbrit nga kontrata e mirëmbajtjes pasi shërbente si rrugë kantieri për projektin e ri. Janë kryer inspektime të vazhdueshme pasi kanë qënë pjesë e kontrates së mirëmbajtje dhe eshte detyrim qe permban kjo kontrate. Këto inspektime gjenerojnë përherë më një raport mujor që përgatitet nga mbikëqyrësi. Jo nuk ka patur problematika të tilla	

	Konkretisht kërkojmë komentin tuaj në lidhje me pyetjet e mëposhtme: 1. Kur aksi i rrugës i dëmtuar në segmentin Librazhd-Përrenjas, ku u shemb dhe Ura e Dragostunjës ka pasur ndërhyrje të fundit mirëmbajtjeje?		paraprakisht pasi do të ndërhyej menjëherë. Nga analiza paraprake dinamika e rrëshqitjes ka ardhur si rrjedhojë e shirave me intensitet të lartë dhe me kohëzgjatje 3-4 mujore duke sjellë plota në lumin Shkumbin i cili ka gërryer trasenë e hekurudhës dhe prishur suportin e binarëve për një gjatësi të konsiderueshme. Më tej mbingopja e shpatit deri ku po zhvillohet aksi i korridorit 8, ka prishur kohezionin e dherave duke sjellë si pasojë aktivizimin e planeve të rrëshqitjeve të njëpasnjëshme. Këto rrëshqitje dëmtuan aksin e vjetër së bashku me urën, trupin e rrugës në ndërtim dhe infrastrukturën e rrjetit të fibrave optike si dhe atë të shtyllave të rrjetit elektrik. Pretendimet e banoreve jane te pabaza pasi vendin e rreshqitjes nuk ka patur shfrytezim te lumit. Institucionet pergjegjese per mjedisin dhe basenet japin leje per shfrytezim te inerteve dhe i monitorojne sipas kriterave ligjore. Për llogaritjen e dëmit jemi në pritje të studimeve të thelluara gjeologo-ixhinierike të cilat do të përcaktojnë thellësinë e planit të rrëshqitjes dhe më tej masat inxhinierike të duhura. Qarkullimi i mjeteve behet i mundur nga data 03.03.2026. Ka dëmtime në disa akse si rezultat i reshjeve te tejzgjatura dhe me intensitet. Nga ana e ARRSH janë evidentuar të gjithë rastet e dëmtimeve dhe po ndërhyhet paralelisht për eliminimin e dëmëve të sjella. ARRSH çdo vit planifikon fonde për ndërhyrje emergjente konform legjislacionit.	
6.3.2026	Rruga ne Himarë fshat eshte me gropa edhe perben rezik per kalimtarete sepse makinat manovrojne tek gropat.Gjithastu rruga eshte prere per te kaluar ujrat e zeza po nuk eshte asfaltuar mire do rimbushje. Ju dergoje fotografi te cilat derguam tek firma Sallilari po duan nga ju aprovim qe te veprojne. Me mirkuptim cel.0697994523	6.3.2026		
7.3.2026	Pershendetje..doja te pyesja se kur fillojn punimet ne rrugen Patos -Fier...kam token ne ane te ruges e doja te filloja nje ivestim...po zdi a me prek rruga e re	7.3.2026		

8.3.2026	Unë, Erlini Qordja, banor në fshatin Ibe e Poshtme, pranë segmentit të autostradës Tiranë–Elbasan, ju drejtohem për të paraqitur një shqetësim serioz lidhur me zhurmën e vazhdueshme që shkaktohet nga trafiku i automjeteve në këtë aks rrugor. Prej kohësh, zhurma e automjeteve është bërë shumë e bezdisshme për banorët e zonës, sidomos gjatë orëve të pikut të trafikut dhe në mbrëmje. Në përpjekje për të vlerësuar situatën, kam kryer matje orientuese të nivelit të zhurmës me pajisje celulare profesionale, ku rezulton se niveli mesatar arrin 82–84 dB(A), ndërsa vlerat maksimale shkojnë deri në 90 dB(A) dhe shpesh në raste shpejtesie të larta e kalojnë vlerën 110 dB(A). Kuota e autostades në raport me shtëpitë e banimit, është me të lartë, bimesia mungon, dhe kjo bën që pikerisht në këtë segment ky problem të jetë më i theksuar. Fshati Ibe e Poshtme dhe Pellumbas që preken nga ky shqetësim kanë atraksione turistike si Shpella e Pellumbasit , Lumi Erzen etj. të cilat vizitohen nga turistë vendas dhe të huaj çdo ditë dhe ky është një shqetësim dhe për to pasi nuk gjejnë këtu atë që kërkojnë, qetësinë e një zone rurale të gjelbëruar .Ky është një shqetësim i cili prek me shumë se 1200 banorë rezidentë të kësaj zone. (Fotografitë e matjeve bashkëlidhen me këtë kërkesë.) Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 435, datë 12.09.2018, dhe Direktivës Europiane 2002/49/EC, niveli i lejuar i zhurmës në zonat pranë rrugëve kryesore nuk duhet të kalojë: · 65 dB(A) gjatë ditës, · 55 dB(A) gjatë natës. Pra, matjet e kryera tregojnë një tejkalim të ndjeshëm të kufijve ligjorë, çka përbën ndotje akustike dhe ndikon negativisht në cilësinë e jetesës së banorëve. Duke qenë se kam formim profesional në fushën e inxhinierisë së ndërtimit dhe njohuri mbi mbrojtjen akustike të mjedisit, sugjeroj që në këtë segment	8.3.2026			

		të autostradës të vendosen barriera akustike në anë të rrugës, në një gjatësi prej rreth 800 metra, sic tregon edhe skica, në përputhje me standardet bashkëkohore të mbrojtjes së mjedisit urban. Personalisht e vlerësoj shumë të vlefshëm një investim të tillë, duke qenë se komuniteti mund të jepet një zgjidhje me një investim modest. Së bashku me këtë kërkesë, bashkëlidh edhe një skicë orientuese ku propozoj pozicionimin e këtyre barrierave. Duke ju falënderuar për vëmendjen dhe për angazhimin tuaj në përmirësimin e infrastrukturës rrugore dhe jetesës së qytetarëve, mbetem në pritje të një përgjigjeje dhe veprimi konkret për këtë problem.			
9.3.2026	Në vijim të përgjigjes suaj ndaj kërkesës sonë për informacion lidhur me projektin infrastrukturor Rrogozhinë-Elbasan (Elbasan - Lekaj), ju lutemi:	1. Të na informoni nëse projekti teknik për segmentin Ura e Grykshit-Rrogozhinë, i cili sipas përgjigjes suaj gjendet i arkivuar në Autoritetin Rrugor Shqiptar, disponohet edhe në format elektronik dhe nëse është e mundur të na vihet në dispozicion në këtë formë, së bashku me relacionin teknik përkatës. 2. Në rast se vënia në dispozicion e projektit kërkon kosto shërbimi sipas nenit 13 të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit", ju lutemi të na informoni mbi procedurën dhe vlerën përkatëse që duhet të paguajmë. 3. Gjithashtu, ju lutemi të na vini në dispozicion informacion dhe dokumentacion për çështjet e paraqitura në kërkesën tonë fillestare që nuk janë trajtuar në përgjigjen tuaj, konkretisht: • studimet paraprake të realizuara për projektin (studim fizibiliteti, studime gjeologjike dhe gjeoteknike, si dhe raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis, nëse disponohet), së bashku me dokumentacionin përkatës;	9.3.2026	Projekti teknik i aksit rrugor Elbasan - Lekaj së bashku me relacionet është material voluminoz dhe shumëfishimi i tij kërkon kohë dhe angazhim stafi. Megjithatë ky projekt nga Elbasani deri në Uren e Grykshit mund të gjendet i publikuar në faqen zyrtare app.gov.al ose në faqe të tjera zyrtare të cilat publikojnë informacione rreth tenderave. Projekti për pjesën nga Ura e Grykshit deri në Rrogozhinë është i papublikuar. Ai gjendet i arkivuar në Autoritetin Rrugor Shqiptar dhe mund të ketë kosto shërbimi konform nenit 13, të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit". Ky projekt bazohet në standardin teknik "Rregullat Teknike të Projektimit dhe Ndërtimit të Rrugeve", miratuar me VKM nr. Nr. 628, datë 15.7.2015.	

		- kontratat e ndërtimit dhe mbikëqyrjes së punimeve, duke specifikuar subjektet zbatuese dhe mbikëqyrëse; - auditin teknik ose auditin e sigurisë rrugore për projektin, nëse është kryer, si dhe dokumentacionin përkatës.			
9.3.2026	Drejtuar: Platformës së Bashkëqeverisjes Objekti: Ankesë për mosveprim administrativ nga Autoriteti Rrugor Shqiptar – Shkresa nr. 7890 prot., datë 02.09.2025 Unë, Erion Pasho, paraqes këtë ankesë në lidhje me mungesën e përgjigjes nga Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH) për kërkesën time lidhur me fondin e shpronësimit në emër të subjektit Enver Gjysma (pasuria nr. 8/368 etj., ZK 8561 – Superstrada Korçë– Kapshticë). Kronologjia e çështjes: • Kërkesa ime është administruar në ARRSH me nr. 7890 prot., datë 02.09.2025. • Me shkresën e datës 24.09.2025, ARRSH më ka kërkuar paraqitjen e dokumentacionit që provon interesin tim të ligjshëm si palë e interesuar drejtpërdrejt. • Më datë 29.09.2025 kam dërguar me email dokumentacionin përkatës për legjitimimin tim. • Më datë 13.02.2026 kam ridërguar kërkesën time duke bashkëlidhur sërish dokumentacionin e plotë, përfshirë të gjitha dëshmitë e trashëgimisë që provojnë zinxhirin e trashëgimisë dhe legjitimitetin tim si trashëgimtar ligjor i subjektit Enver Gjysma. Derisa nuk kam marrë asnjë përgjigje zyrtare nga ARRSH, mbeten të paqarta çështjet: 1. Vlefshmëria e dokumentacionit të paraqitur; 2. Ekzistenca e fondit të papaguar të shpronësimit; 3. Statusi aktual i procedurës. Theks i veçantë: Ju informoj se është teknikisht e pamundur të paraqitet certifikata e pronësisë për pasurinë 8/368 dhe pasuritë e tjera të shpronësuar, pasi pas shpronësimit një certifikatë e tillë nuk mund të ekzistojë. Vendimi gjyqësor nr. 1099, datë 28.07.1999, është vendim i faktit juridik, i cili vërteton statusin pronësor të mëparshëm. Gjithashtu, krahas vendimit 1099, dokument i mjaftueshëm	9.3.2026	Ne përgjigje te ankeses suaj ju informojme se: ARRSH ju ka informuar me shkreses nr.7890/1 prot., date 24.09.2025, nepermjet se ciles jeni ne dijeni. Ju duhet te plotesoni kushtet ligjore per te dorezuar prane nesh nje kopje te dokumentacionit ligjor te cituar ne shkrese.		

		ligjor është vërtetimi i pronësisë i ASHK-së nr. 12285/86 Prot. mbi statusin juridik të pasurive, sipas nenit 14 të Ligjit nr. 8561/1999 për shpronësimin. Në këto kushte, ndodhemi përpara një mosveprimi administrativ pas plotësimit të dokumentacionit të kërkuar nga vetë institucioni. Kërkoj ndërhyrjen e Bashkëqeverisjes për të: 1. Verifikuar trajtimin e kërkesës nr. 7890 prot.; 2. Detyruar ARRSH të japë përgjigje zyrtare dhe të arsyetuar për këtë çështje brenda një afati të arsyeshëm; 3. Sqaruar menjëherë statusin e fondit të shpronësimit dhe të konfirmuar dokumentin ligjor të mjaftueshëm për pasuritë e shpronësuara. Shënim: Në kërkesën time fillestare kam deklaruar se jetoj jashtë Republikës së Shqipërisë dhe kam kërkuar që komunikimi të kryhet me email, por përgjigjja e parë më është dërguar me postë fizike në adresën time në Korçë. Faleminderit për bashkëpunimin tuaj të vazhdueshëm			
9.3.2026	Uroj ky email t'ju gjeje mire. Une jam Genta, gazetare e medias rajonale te biznesit Seenews, me seli ne Sofje te Bullgarise. Ju shkruaj per t'ju kerkuar informacion shtese ne lidhje me proceduren e prokurimit "Emergjencë masa parandaluese mbi rrëshqitjen në zonën e quajtur “Ligata e Biciti”, Dragostunjë”. Do ta vleresonim nese mund te na informoni ne lidhje me operatorin ekonomik me te cilin po behet negocimi.	9.3.2026	Në lidhje me kërkesën tuaj për informacion mbi operatorin ekonomik me të cilin po zhvillohet negocimi në kuadër të procedurës së prokurimit “Emergjencë – masa parandaluese mbi rrëshqitjen në zonën e quajtur ‘Ligata e Biciti’, Dragostunjë”, ju bëjmë me dije se informacioni i kërkuar aktualisht nuk është i disponueshëm. Kjo pasi Autoriteti Kontraktor ka hartuar vetëm regjistrin e parashikimeve për këtë objekt dhe, deri në këtë moment, nuk ka nisur ende procedura e prokurimit.		
9.3.2026	Jam Esmeralda Keta, gazetare ne Top Channel: Ju lutem, kemi nevojë për disa informacione nga ana juaj: - Si paraqitet situata ne terren ne objektin "Ura e Milotit" mbi lumin Mat? Cilet jane faktoret qe kane cuar				

		ne degradimin e saj? Sa ka kushtuar nderhyrja rehabilituese dhe cila kompani e ka realizuar? Kur kane perfunduar punimet dhe a eshte hapur per qarkullimin e automjeteve? - Ne cfare ka konsistuar konkretisht kjo nderhyrje? - A ka dale nga rreziku ky objekt? Cilat jane planet per ta ruajtur kete objekt?			
10.3.2026	Ne jemi gazetarë nga Rrjeti për Raportimin e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit të cilët po punojmë në lidhje me një cikël shkrimesh për akset rrugore në Shqipëri. Gjatë shqyrtimit të informacioneve na kanë lindur disa pyetje për të cilat do të luteshim të kishim komentin tuaj në mënyrë që raportimi jonë të jetë sa më i saktë dhe afër së vërtetës. Konkretisht kërkojmë komentin tuaj në lidhje me pyetjet e mëposhtme: 1. Kur aksi i rrugës i dëmtuar në segmentin Librazhd-Përrenjas, ku u shemb dhe Ura e Dragostunjës ka pasur ndërhyrje të fundit mirëmbajtjeje? 2. A ka kryer ARRSH inspektime periodike mbi gjendjen e këtij segmenti përpara dëmtimit? 3. A ka pasur sinjalizime apo raporte paraprake për rrezik rrëshqitjeje dherash apo dëmtime strukturore në këtë zonë? 4. A janë marrë masa për mbrojtjen e trupit të rrugës nga erozioni i lumit Shkumbin? 5. A ka koordinuar ARRSH me institucionet e tjera (AKM, AMBU) për aktivitetet e shfrytëzimit të inerteve pranë rrugës?	11.3.2026	Përgjigje: Segmenti rrugor Librazhd – Përrenjas është mbuluar rregullisht me mirëmbajtje rutinë. Sa herë që janë evidentuar problematika në këtë segment rrugor janë marrë masat e duhura për eliminimin e tyre. Përgjigje: Janë kryer inspektime të vazhdueshme pasi kanë qënë pjesë e kontrates së mirëmbajtje dhe eshte detyrim qe permban kjo kontrate. Përgjigje: Jo nuk ka patur problematika të tilla. Përgjigje: Kufiri i lumit Shkumbin nuk ka qënë pranë trupit të rrugës, por pranë trasesë së linjës hekurudhore. Kufiri rrugor është rreth 85 m larg linjës hekurudhore, rreth 25 m mbi kuotën e hekurudhës dhe rreth 30 m mbi kuotën e lumit Shkumbin. Përgjigje: Shkaku kryesor i dëmtimit të rrugës është gërryerja e shpateve nga lumi Shkumbin, sasia e madhe e reshjeve atmosferike për gati tre muaj që ka çuar në mbingopje të strukturave të tokës, rritja e nivelit dhe sasisë së ujrave nëntokësore, si dhe dobësimi i strukturës së tokës së kësaj zone në prani të ujrve sipërfaqësore dhe nëntokësore. Përgjigje: Nuk është kompetencë e ARRSH		

	6. Sipas ARRSH, cilat janë shkaqet konkrete të dëmtimit të rrugës? 7. Cili është komenti juaj lidhur me pretendimet të banorëve të zonës dhe ekspertëve të cilët e lidhin rrënimin e rrugës me shfrytëzimin jashtë kriterëve të inerteve dhe gërryerjeve në lumin Shkumbin? . 8. A ka një vlerësim paraprak të dëmit ekonomik dhe sa kohë pritet të zgjasë rikthimi në funksion i plotë i aksit? 9. Sa të sigurta janë aktualisht akset kryesore rrugore në vend, duke qënë se një pjesë e madhe e tyre janë dëmtuar dhe a ekziston rreziku që situata të ngjashme me atë të Librazhd-Pogradec të përsëriten në segmente të tjera? 10.Çfarë masash urgjente dhe afatgjata po merren për të parandaluar përsëritjen e situatave të ngjashme?		Përgjigje: Nuk kemi akoma një vlerësim paraprak të dëmit ekonomik (termi “dëm ekonomik” përmbledh shumë elementë ekonomikë dhe nuk mund të bëhet nga ARRSH). Përgjigje: Sa herë janë evidentuar raste të gërryerjeve nga lumi i është dërguar shqetësimi AMBU. Por, theksojmë se nuk jemi në përgjegjësi për monitorimin e lumenjve. Përgjigje: Nga ana e ARRSH janë evidentuar të gjithë rastet e dëmtimeve, të cilat nuk përbëjnë pjesë të madhe të akseve rrugore. Në të gjitha rastet e evidentuara po ndërhyhet ose po përgatitet dokumentacioni përkatës për ndërhyrje për eliminimin e këtyre dëmeve. Këto dëmtime kanë ardhur si rezultat i reshjeve të tejkzgjatura dhe me intensitet gjatë këtij sezoni. Sa herë të ketë situatë të ngjashme (të cilat nuk varen nga ne) ARRSH do të ndërhyjë për eliminimin e dëmeve që sjellin këto situata me masat që parashikohen në kontratat e mirëmbajtjes, me masat e nevojshme për punimet që janë brenda afatit të garancisë së punimeve. Në raste dëmsh që nuk parashikohet në këto kontrata, vendoset të ndërhyet me projekt të veçantë. Përgjigje: Masat urgjente dhe afatgjata janë inspektimet e vazhdueshme të akseve rrugore në administrim të ARRSH, të cilat janë pjesë detyrueshme e zbatimit të kontratave të mirëmbajtjes	
12.3.2026	Pershendetje ,ngre nje shqetësimi qe s po përfundon ura qe lidh rrugen 5 maji me unazën e re te babrroit kollonat jane te perfunduar ,nene kalimi cdo gje e perfunduar edhe kollonat vete per traretkat ngelur dhe letesin shume trafikun e zonës edhe te paskuqanit ,duhet te perfundoje sa me shpejt se zgjidh shume problemin e trafikut	12.3.2026	Ky projekt nuk eshte i ARRSH-se. Po e delegojme prane zyres se pushtetit vendor.	

2.3.2026	Jam Kryeplaku i fshatit Zvezdë, Njësia Administrative Pojan, Bashkia Maliq . Po ju nis një ankesë të cilën ma përcollën 40 familje të fshatit në lidhje me ujrat e zeza , pasi tubacioni ekzistues është bllokuar dhe ujrat derdhen mbi asfalt duke sjelle ndotje dhe dëmtuar jetën e qytetarëve duke e bërë të pamundur jetesën sepse janë burim infeksioni. Kërkojmë nga ana juaj si autoritet të na lejoni për të kryer një prerje tërthore të asfaltit në rrugën nacionale Zvezdë-Podgorie lapidari për të zgjidhur këtë problematikë që na është krijuar, dhe investimi për këtë problematikë po bëhet nga vetë banorët. Shpresojmë që kërkesa jonë të meret parasysh. Me respekt kryeplaku i fshatit Zvezdë dhe banorët e fshatit!	12.3.2026	Me qellim zgjidhjen e problematikes se komunitetit te fshatit Zvezde, kerkese e ardhur nga kryeplaku I fshatit dhe nje grup banoresh, ne rrugen kryesore Lapidari Podgorie - Zvezde, miratojme kryerjen e punimeve nga vete komuniteti per hapjen e kanalit me permasa gjatesi 6.5 ml dhe gjeresi 0.3 ml me qellim kalimin e tubit te ujrave te zeza, duke zbatuar kushtet e meposhtme: 1. Te merren masat per kufizimin e zones se punimeve me qellim shmangien e aksidenteve, 2. Te punohet me pjesore me qellim mospengimin e trafikut, 3. Gjate germimit te mos depozitohen ne rruge, 4. Pas perfundimit te punimeve, gjate asfaltimit te merret ne konsiderate fakti qe gjeresia e asfaltimit te jete me e madhe se sa gjeresia e kanalit. Keto punime do te monitorohen nga specialistet e Drejtorise se Rajonit Qender Lindje Korce.		
12.3.2026	Ne Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë eshte paraqitur kerkese e nje qytetare te Bashkise Belsh (bashkelidhur), ne te cilën kërkohet të merren masa për kufizimin e shpejtësisë së mjeteve ne rrugen Elbasan-Kuçovë, fshati Marinëz.				

		Sipas fushes tuaj te përgjegjësisë, lutemi shqyrtimin e kësaj kërkesë. Përsa do të konkludoni të informohet zyrtarisht kërkuesi, duke vënë në dijeni dhe Ministrinë.			
14.3.2026		Pershendetje doja tu dergoja kete video dhe te shikoni ne cfare gjendje ndodhet rruga vath turja ne durres aksi tregu i makinave deri ne sektori rinia video eshte bere ne dimer por tani qe rruga eshte thare nga uje pluhuri i rruges po e ben te pa durushem qendrimin sepse sa zgjohesh ne mengjes eshte pluhuri i madh ju lutem shikojeni te beni diqka ose ne zone ka shum kantjere pune te pakten ta mirmbajen se e kane bere gjith gropa. Ju faleminderit nese e merrni per baze kete shqetesim	14.3.2026	Ne pergjigje te ankeses se meposhteme, sqarojme se rruga" Vath Turja" nuk ben pjese ne inventarin e rrjetit rrugor kombetar qe administrohet nga Arrsh. Po e delegojme prane pushtetit vendor.	
14.3.2026		Po ju drejtohem si banor i fshatit Mejdan, në Bashkinë Tropojë, për të ngritur një shqetësim shumë serioz lidhur me gjendjen e rrugës që lidh këtë zonë me pjesët e tjera të rajonit. Gjendja e kësaj rruge është jashtëzakonisht e rënduar dhe përbën rrezik real për sigurinë e banorëve dhe të automjeteve. Rruga është e dëmtuar rëndë, me gropa të shumta dhe mungesë të plotë mirëmbajtjeje, duke e bërë qarkullimin shumë të vështirë dhe shpesh edhe të rrezikshëm. Kjo situatë ka krijuar vështirësi të mëdha për banorët e zonës, për transportin e përditshëm, për shërbimet emergjente dhe për zhvillimin normal të jetës në komunitetin tonë. Për një zonë të banuar është e papranueshme që rruga të lihet për një kohë kaq të gjatë në këtë gjendje. Në cilësinë e institucioneve përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe sigurinë e infrastrukturës rrugore, ju kërkojmë që të ndërmerri masa urgjente për inspektimin dhe rehabilitimin e kësaj rruge. Ju lutem të na informoni për hapat konkretë që do të ndërmerren për zgjidhjen e këtij problemi. Në rast se kjo çështje vazhdon të mos trajtohet, banorët e zonës do të detyrohen ta bëjnë këtë problem publik përmes mediave dhe institucioneve të tjera përkatëse. Në pritje të reagimit tuaj sa më të shpejtë.	14.3.2026	Ne pergjigjie te ankeses se meposhtme ju bejme me dije se ky seksion rrugor nuk administrohet nga ARRSH keshtu qe po e delegojme prane institucionit perkates vendor.	

15.3.2026	Uroj te jeni mire dhe ta lexoni kete mesazh. Ju lutem,doja te njoftja nje shqetesim shume te madhe per segmentin e rruges nga pas Casa Italia - Astir.I kane çare rrugen ne 4 vende per arsye punimesh dhe ka 1 muaj qe i kane kene pa mbushur. Ju lutem ,mund te interesoheni dhe te jepni urdher ta kthejne ne gjendjen e mepershme. Faleminderit shume	15.3.2026	Ne pergjigjie te ankeses se meposhtme ju bejme me dije se ky seksion rrugor nuk administrohet nga ARRSH keshtu qe po e delegojme prane institucionit perkates vendor saktesisht prane Bashkise Tirane.	
13.3.2026	Kërkoj nga ana juaj të verifikoni punimet që po kryen te Ura e Dajlanit në Durrës pasi është ngushtuar rruga nga 3 korsi në 1 direkt në rrethrotullim dhe qarkullimi bllokohet si për të dalë por dhe për tu futur në rrethrotullim. Ky ngushtim rruge është absurd, kur duhet te jene patjetër dy korsi dhe ska pse zgjerohet trotuari dhe per me teper me ca forma te cuditshme. Duhet të verifikohet urgjent nga ana juaj, pasi ne jemi përdorues të perditshem dhe po na rrezikoni dhe veshtiresoni jeten. . Gjithashtu, mire qe kane ngushtuar rrugen, por nuk eshte vendosur asnje sinalistike paralajmeruese.	17.3.2026	Ne pergjigjie te ankeses se meposhteme sqarojme se: Punimet qe po kryhen poshte ures se Dajlanit nuk jane ne rruget qe administrohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.	
17.3.2026	Nëpërmjet këtij emaili dëshiroj të paraqes një problematikë të rëndësishme që lidhet me organizimin e qarkullimit rrugor në zonën e Terminalit të Autobusëve të Jugut në Tiranë. Aktualisht, automjetet që dalin nga terminali për t'u futur në autostradë janë të detyruara të bëjnë një devijim të gjatë drejt zonës së Kamzës për të arritur në një rrethrotullim dhe më pas të kthehen në drejtimin e autostradës. Ky konfigurim krijon zgjatje të panevojshme të itinerarit, rritje të trafikut dhe humbje kohe për qindra automjete çdo ditë. Nga vëzhgimi në terren, rezulton se ekziston mundësia teknike që përmes vendosjes së një semafori dhe organizimit të një	17.3.2026	Ne pergjigjie te ankeses se meposhteme sqarojme se: Rruga e Kamzes ku eshte Terminali I autobuzeve per ne jug nuk eshte ne inventarin e rrjetit rrugor qe administrohet nga Autoriteti rrugor Shqiptar. Po keshtu as rruga dytesore Tirane Vore ku kerkohet nderhyrje nuk eshte ne inventarin e rrjetit rrugor kombetar qe administrohet nga ARRSH.	

	daljeje të drejtpërdrejtë nga terminali, automjetet të mund të lidhen direkt me rrethrotullimin që të nxjerr në autostradë. Kjo do të shmangte devijimin e gjatë dhe do të përmirësonte ndjeshëm qarkullimin në këtë zonë. Gjithashtu, në hyrjen për në Tiranë nga rruga dytesore QTU, aktualisht automjetet janë të detyruara të futen në rrethrotullim për të ndryshuar drejtimin. Në krah të rrugës ekziston hapësirë e mjaftueshme për të krijuar dy kalime direkte që do të mundësonin hyrje më të lehtë në qytet dhe do të reduktonin ndjeshëm trafikun në rrethrotullim. Duke qenë se kjo zonë përbën një nyje të rëndësishme të transportit ndërqytetas dhe të hyrje-daljes në Tiranë, do të ishte shumë e dobishme që institucionet përkatëse të kryenin një vlerësim teknik të kësaj situate dhe të shqyrtonin mundësinë për përmirësimin e organizimit të qarkullimit.			
17.3.2026	Shoqëria “EUROPETROL TRANS” Sh.p.k është pronare e pasurisë Nr. i pasurisë <u>4/15</u>, Zk.8517, regjistruar ne regjistrin e pasurive te paluajtshme ASHK Durrës me Kodin Unik <u>8517028160</u>, Indeksi i Hartës Kadastrale K-34-87-238-B, me sipërfaqe 20.000 (njëzetë mije) m2, e llojit “Truall”, ndodhur në Porto Romano, Bashkia Durrës. Rezulton se mbi një pjesë të pasurisë tonë të mësipërme, është ndërtuar rruga rruga Durrës Ecopark – port MBM, rruge e cila nen dijeninë tone është ndërtuar nga Autoriteti Rugor Shqiptar. Deri në këto momente nuk kemi asnjë informacion në lidhje me pasurinë tonë që është zënë nga rruga dhe nuk kemi marre asnjë komunikim zyrtat mbi shpronësimin e saj. Sa me sipër ju lutemi na informoni në lidhje me faktin nëse ka ndonjë vendim shpronësimi për pasurinë Nr. i pasurisë	17.3.2026		

		4/15, Zk.8517, në pronësinë tone mbi të cilën është ndërtuar rruga. Nëse pasuria në pronësinë tone Nr. i pasurisë 4/15, Zk.8517, nuk është shpronësuar, ju lutemi na orientoni për proceduar që duhet të ndiqen për tu bërë shpronësimi.			
19.3.2026	Unë, (Gazmen Vullnet Onuzi), banues në fshatin Nangë, RRUGA Kukes-Peshkopi paraqes këtë kërkesë për shkak të rrezikut të lartë që paraqet qarkullimi i mjeteve me shpejtësi të lartë në këtë zonë. Segmenti në fjalë ndodhet shumë pranë banesave dhe përdoret çdo ditë nga banorët, përfshirë fëmijët që lëvizin për në shkollë dhe kopesht. Shpejtësia e mjeteve është e lartë dhe e pakontrolluar, duke krijuar rrezik serioz për jetën dhe sigurinë e banorëve. Në këto kushte, kërkoj nga ana juaj: Marrjen e masave konkrete për uljen e shpejtësisë së mjeteve në këtë segment rrugor; Vendorsjen e sinjalistikës paralajmëruese dhe kufizuese të shpejtësisë; Vlerësimin teknik për vendorsjen e elementeve fizike të sigurisë (si kufizues shpejtësie ose alternativa të tjera sipas standardeve); Ne rast se nuk merren masa nga ju do të mbledh firmat e banorve të zonës dhe me lejen e kryeplakut të fshatit do marr persiper shpenzimet dhe përgjegjësin për të vendosur vet dy kufizues shpejtësie ose në gjuhën popullore dy (Bordura në rrugë) për garantimin e sigurisë rrugore në këtë zonë banimi: Shpresoj që kërkesa jonë të merret parasysh dhe të bëhet një zgjidhje sepse rrezikojmë shumë fëmijët dhe njëzërit të tjerë ju	19.3.2026			
19.3.2026	Nga verifikimi i shkresës suaj Nr.2439 prot datë 12.03.2026 protokolluar nga ana jonë me Nr.1316 prot datë 17.03.2026 me lëndë: “Kërkesë për zhvillimin e procedurës së prokurimit me objektivitet “Blerje karburanti viti 2026-2027-2028 për institucionin e ARRSH-së”, ju bëjmë me dije se	19.3.2026			

	kërkesa e përcjellë pranë Organit Qëndror Blerës nuk është e hartuar sipas VKM-së dhe Rregullores së OBP-së . Autoritetet Kontraktore Përfituese, në hartimin e dokumentacionit për zhvillimin e procedurave pranë Organit Qëndror Blerës , OBP sha, duhet te bazohen në Rregulloren e Komunikimit Institucional nëpërmjet OBP sha dhe Autoriteteve Kontraktore <i>publikuar në faqen zyrtare të Organit Qëndror Blerës</i> ku përcaktohen qartë rregullat, afatet dhe procedurat që do të ndiqen në mënyrë të përqëndruar nga OBP, si dhe referuar pikës 13/1 të VKM-së 531/2023 i ndryshuar ku citohet: <i>13/1. Autoritetet/entet kontraktore paraqesin kërkesën për prokurim në formë shkresore dhe elektronike, në të cilën bashkëlidhin në formën e duhur të dhënat e domosdoshme teknike dhe sasiore që janë të nevojshme për procedurën, objekt prokurimi, duke përfshirë:</i> <i>a) përshkrimin/emërtesën e objektit të prokurimit, i cili të përputhet me zërin përkatës në regjistrin e parashikimit;</i> <i>b) vlerën e përllogaritur të kontratës (pa TVSH) dhe mënyrën e përllogaritjes, fondi limit, në përputhje me parashikimet e ligjit për prokurimet publike dhe rregullave të prokurimeve publike, shoqëruar me dokumentacionin provues të këtij procesi;</i> <i>c) sasinë e mallrave/shërbimeve, si dhe grafikun e lëvrimit të mallrave/shërbimeve;</i> <i>ç) specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, projektin apo oponencën teknike, nëse është rasti, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme referuar parashikimeve konkrete të ligjit për prokurimet publike dhe rregullave të prokurimeve publike, të shoqëruar me procesverbal argumentues;</i> <i>a) preventivin/at e punimeve, nëse është rasti, projektet teknike, grafikun e zbatimit të punimeve, i cili të përfshijë</i>			
--	--	--	--	--

		<i>fazat, afatet e realizimit të punëve, vendin e realizimit të kontratës/furnizimit/dorëzimit të mallit/shërbimit.</i> Për sa më lart, të paraqitet në OBP procesverballi mbi hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit hartuar nga personi përgjegjës/grupi i punës i caktuar me Urdhër nga Titullari i Institucionit tuaj ku të përfshihen: (lloji i procedures, mënyra e lëvrimit të lëndës djegëse, afati i lëvrimit, specifikimet teknike të lëndës djegëse (për përcaktimin e standartit referojuni faqes zyrtare të DPS) dhe përlllogaritja e fondit limit të procedurës. Ky procesverbal duhet të nënshkruhet në ç’do faqe nga personi përgjegjës ose grupi i punës i caktuar nga Titullari i AK-së. Për sa më sipër, në zbatim të përcaktimeve të nenit 67 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Rregullat e Prokurimit Publik” i ndryshuar, të saktësohen vlerat dhe dokumentacioni të dërgohet pranë OBP-së. Dokumentacioni i dërguar duhet të jetë origjinal ose në rast se është fotokopje të jetë i njësuar me origjinalin nga institucioni juaj.			
26.2.2026	Jam Suela Gjidede, gazetarë pranë Politico.al Po ju drejtohem për të kërkuar informacion zyrtar lidhur me bllokimin prej disa ditësh të aksit rrugor Librazhd–Prrenjas, pas shembjes masive të ndodhur në këtë segment. Duke qenë se ARRSH është institucioni përgjegjës për administrimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve kombëtare, ju lutem a mund të na vini në dispozicion: 1. Raportin teknik paraprak mbi shkaqet e shembjes; 2. Vlerësimin gjeologjik të zonës dhe nivelin e rrezikut aktual; 3. Masat konkrete të ndërmarra deri tani për stabilizimin e trupit të rrugës; 4. Afatin e parashikuar për rihapjen e qarkullimit;	25.3.2025	Referuar kërkeses Suaj ne lidhje me bllokimin e aksit Librazhd–Prrenjas ne vendin e quajtur "Arrat e Gurres" ju informojme se Raporti teknik dhe Vleresimi gjeologjik i zones dhe niveli i rrezikut aktual nuk jane perfunduar, jemi ne pritje te dorezimit te tyre. Gjithashtu ju informojme se rihapja e trafikut eshte realizuar pas 10 dite bllokim dhe devijimi i trafikut u krye duke sugjeruar drejtuesit e mjeteve perdorimin e akseve rrugore Elbasan - Gramsh - Lozhan - Maliq per autoveturat dhe furgonat dhe Qafe Thane - Bllate - Rruga e Arbrit - Tirane per mjetet e transportit te mallrave.		

		5. Planin e devijimit të trafikut dhe sinjalistikën e përkohshme të vendosur. Kjo kërkesë bëhet në mbështetje të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.			
18.3.2026	Jam nje person qe ushtroj aktivitet ne Adresen: Superstrada e Devollit ne qytetin e Bilishtit. Kerkoj te rezervoj 1 vend parkimi para biznesit tim por ne Bashkia Bilisht me thane qe institucioni qe eshte pergjegjes per kete gje eshte ARRSH. Ju lutem me tregoni cfare procedure duhet ndjekur.	19.3.2026	Ne pergjigje te kerkeses se meposhtme sqarojme se ARRSH nuk lejon parkime pergjate rrugeve kombetare, pervec vendqendrimeve/xhepave te percaktuar me projekt.		
23.3.2026	Me ane te ketij E-Mailit po ju dergoj kerkesen time zyrtare per vlersimin dhe kompensimin e punimeve te kryera deri tani ne truallin dhe kantierin nen ndertim ne zonen e librazhdit prane rruges nacionale. Bashkengjitur do te gjeni letershkirmin dhe dokumentet e nevojshme, te disponueshme per procedurat e metejshme nga ana juaj. Per cdo pyetje ose informacion te paqarte ju lutem te me kontaktoni, jam me kenaqesi ne dispozicionin tuaj.	23.3.2026			
22.3.2026	Pershendetje si kaluat doja te pyesja per nje ndertes tip fast food grill me konstruksion druri sa eshte distanca qe duhet te ruaj na rruga ? Aksi gjirokaster-tepelene Disponoj token me certifikat pronesie .	24.3.2026	Ne pergjigje te kerkeses se meposhtme, ju sqarojme si vijon: Rruga Tepelene - Gjirokaster është Rrugë Interurbane Dytësore kategoria C referuar nenit 25, pika 2, 3, dhe 5, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr 153, datë 07.04.2000, “Për miratimin e Rregullores së Zbatimit të		

				Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë” distancat e lejuara për ndërtim jashtë qendrave të banuara janë: Neni 25. Brezat e Rezervuara Jashtë Qendrave të Banuara (Neni 16 i Kodit Rrugor) 2. Jashtë qendrave të banuara, sic percaktohet në Nenin 4 të kodit, distancat e kufirit rrugor, që duhen respektuar në ndërtimet e reja, në rindërtimet në vazhdim apo shembjet të kompletë, apo në punimet zgjeruese përballë rrugës, nuk mund të jenë më pak se: c) 30 m për rruget e tipit C 3. Jashtë qendrave të banuara, sic është percaktuar në drejtësitë e Nenit 4 të Kodit Rrugor, por brenda zonave të parashikuara për të bërë ndërtime apo të ndryshueshme nga veprimtaria urbanistike e përgjithshme, në rastet kur veprimtaria në fjalë është e miratuar për zbatim direkt, ose edhe kur për këtë zonë të jenë kryer veprimtari urbanistike në zbatim, distancat e kufirit rrugor, që duhen respektuar në ndërtimet e reja, në rindërtimet në vazhdim, shembjet të kompletë apo në zgjerimet përballë rrugëve, nuk mund të jenë më pak se: c) 10 m për rruget e tipit C	
--	--	--	--	---	--

				VO: Ne cdo rast per cdo lloj ndertimi ju duhet te pajiseni me leje ndertimi.	
25.3.2026	<i>Me 25.02.2026 kam përcjellë një kërkesë për informacion pranë Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH). Me datë 18.03.2026, kam marrë një përgjigje nga ARRSH, e cila ishte e pjesshme. Konkretisht, pyetjes nr. 2:</i> <i>“Sa është kostoja për ndërtimin dhe rrethimin për secilin nga këto akse rrugore?”</i> <i>nuk i është dhënë përgjigje.</i> <i>Fillimisht, institucioni pretendoi se pyetja nuk ishte e qartë. Në vijim, e ridërgova kërkesën të formuluar më qartë. ARRSH kërkoi shtyrje afati për kthimin e përgjigjes, por edhe pas kalimit të këtij afati dhe një emaili rikujtues nga ana ime, nuk kam marrë ende përgjigje për këtë pikë.</i>				
6.3.2026	Emisioni investigativ PLUG po analizon disa te dhena qe lidhen me infrastrukturen rrugore ne Shqiperi. Sa me siper kerkojme te informohemi nga ju: Listen e plote te kompanive te cilat kane fituar procedurat tenderuese per supervizimin e punimeve per rruget gjate periudhes 2018-2025. Nese do mundeshit per çdo kompani do te donim dhe cilen rruge kane supervizuar.	10.3.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion lidhur me listën e kompanive që kanë fituar procedurat tenderuese për supervizimin e punimeve rrugore gjatë periudhës 2018–2025, ju bëjmë me dije se, sektori i prokurimeve disponon të dhëna për kontratat e lidhura për shërbimin e supervizimit të punimeve nga sistemi i prokurimit elektronik (regjistri i realizimit). Sqarojmë se në këtë sistem nuk disponohen të dhëna për vitin 2018, pasi procedurat e prokurimit për këtë periudhë nuk zhvilloheshin në mënyrë elektronike. Bashkëlidhur do të gjeni informacionin që disponohet nga institucioni ynë.		
		27.3.2026	Në vijim të komunikimit dhe në përgjigje të kërkesës suaj për informacion lidhur me operatorët që kanë kryer supervizimin		

				e punimeve rrugore për periudhën 2019 – 2025, ju bëjmë me dije se: Informacioni i përcjellë nga ana jonë pasqyron operatorët e supervizimit të punimeve, bazuar në sistemin e prokurimit elektronik (regjistri i realizimit). Gjithashtu, informacionin e kërkuar mund ta gjeni edhe në linkun e mëposhtëm, duke përzgjedhur në dritaren “Kërkim i avancuar” autoritetin kontraktues “Autoriteti Rrugor Shqiptar”. Linku (https://www.app.gov.al/regjistri-i-realizimeve/)	
29.3.2026	Ju drejtohem për të shprehur interesin tim për pozicionin Asistente Administrative pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar. Bazuar në përvojën time në administratë dhe menaxhim dokumentacioni, kam aftësi të mira në organizim, arkivim dhe koordinim të proceseve të zyrës. Jam e orientuar ndaj detajeve, e përgjegjshme dhe e aftë të punoj në mënyrë efikase në mjedise dinamike. CV-ja ime është bashkëlidhur për shqyrtim.	30.3.2026	Ne pergjigje te shprehjes se interesit/kerkeses suaj referohuni ne njoftimet per vende vakante ne faqen zyrtare te ARRSH dhe aplikoni sipas kerkesave		
25.3.2026	Kërkoj të më vihet në dispozicion informacion/dokumentacioni mbi: 1. Sa është kostoja vjetore e mirëmbajtjes për secilin nga akset rrugore të mëposhtme: • Rruga Lumi i Vlorës • Rruga Korçë-Voskopojë (SH63) • Rruga Kombëtare SH6 (Milot-Burrel-Peshkopi) ose Rruga e Arbrit	26.3.2026	• <i>Rruga Kombëtare SH75 (Korçë-Ersekë-Leskovic)</i> • <i>Rruga Korçë-Voskopojë (SH63)</i> Akset per te cilat kerkoni info nuk kane rrethim. Disa nga keto akse nuk jane te ndertuara nga ARRSH. Disa jane me investime miks midis ARRSH dhe FSHZH. Aksi SH3 (Tiranë – Elbasan – Qafë Thanë – Pogradec – Korçë) jane investime qe fillimet e tyre datojne qe ne vite 2000 kur nuk ekzistonte sistemi kompjuterik ne institucion.		

	• Rruga Kombëtare SH75 (Korçë-Ersekë-Leskovik) • Qukës-Qafë-Plloçë (pjesë e aksit SH3, Korridori VIII) • Rruga Lezhë-Shëngjin (SH32) • Rruga Kombëtare SH3 (Tiranë – Elbasan – Qafë Thanë – Pogradec – Korçë) • Rruga Kombëtare SH75 (Korçë – Ersekë – Leskovik) • Rruga Kombëtare SH63 (Korçë – Voskopoje) 2. Sa është kostoja për ndërtimin dhe rrethimin për secilin nga këto akse rrugore?		Aksi Korce - Erseke ka kushtuar 88 milion Euro per 35 km me tvsh. Rruga Voskop - Voskopoje 447 milion leke me tvsh per 10.8 km • Rruga Kombëtare SH6 Rruga e Arbrit per kontraten e PPP (Permiresim, ndertim, operim dhe mirembajtje) 33.6 miliard leke Pa tvsh.	
23.3.2026	Pershendetje, quhem Ardian Kolo dhe doja te di se ku duhet te drejtohem per te perfituar vleren e shpronesimit per interes publik , prone e prekur nga By pass I kanines Vlore , me VKM nr 431 dt 26.06.2024 , pasuria me nr 936/1,ZK 2074 ,sip e prekur eshte 257 m2 dhe vlera e llogaritur 52428 lekë.	30.3.2026	Bazuar në ligjin nr.8561 datë 22.12.1999, “Për shpronësim dhe marrje në përdorim të përkohshëm të pasurive pronë private për interes publik”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të tij, ju duhet te depozitoni prane Agjencise Shteterore per Shpronesim dokumentacionin ligjor per likuidim.	
2.4.2026	Unë që po ju shkruaj, Armando Ndoka, jam banor i lagjes nr.4 ne afersi te rrugës "5 Maji" në Tiranë. Përmes këtij emaili, dëshiroj të ushtroj të drejtën time për informim lidhur me projektin e infrastrukturës që parashikon lidhjen e rrugës "5 Maji" me Unazën e Madhe të Tiranës (Loti Verior), përmes urës mbi lumin e Tiranës. Duke qenë se ky projekt ka një ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e përditshme të banorëve të zonës, si dhe në			

		vlerën e pronave tona, kërkoj zyrtarisht informacion mbi pikat e mëposhtme: 1. Afati i parashikuar: Kur pritet të nisin punimet për këtë urë lidhëse dhe cili është afati zyrtar për përfundimin e saj? 2. Projekti Teknik: A mund të na vihet në dispozicion një planimetri ose informacion se ku do të jetë saktësisht pika e takimit të rrugës "5 Maji" me Unazën? 3. Statusi i Shpronësimeve: Nëse ka prona që preken në bregun e lumit për këtë nyje, në çfarë faze është procesi i shpronësimeve?			
2.4.2026	Une jam Anisa Ramallari dhe jam diplomuar ne Inxhineri Ndertimi (Bachelor), aktualisht jam ne perfundim te vitit te pare te Masterit ne Infastrukture Transporti. Jam e interesuar te zhvilloj nje praktike profesionale ne fushen e infrastruktures rrugore dhe do te doja te kontriboja dhe te fitoja eksprience prane Autoritetit Rrugor Shqiptar, vecanerisht ne projekte qe lidhen me projektimin, zbatimin dhe mbikeqyrjen e punimeve rrugore. Kam njohuri ne AutoCAD dhe Advance Concrete, si dhe perdorim te mire te paketes Microsoft Office (Word, Excel, Power Point).				
3.4.2026	Përshëndetje! Uroj që ky email tju gjejë mirë. Më pishtë bashkëngjitur me këtë email, gjeni të bashkëlidhur një				

	kërkesë për informacion. Faleminderit. Stafi Emisioni 'Në Shënjestër' Arsyeja që po ju shkruaj ka të bëjë me projektin rrugor Bypass i Tiranës. Konkretisht, dua të bëj një sugjerim për të bërë një ndryshim në këtë projekt, një hyrje-dalje në pjesën Stërmas/Picall sepse kjo gjë është jetike për Njësinë Administrative të Baldushkut por edhe për zonat aty përreth Dumje, Tagan, Vishnje, Arban dhe gjithë Njësia Admininstrative e Baldushkut. Kam parë që projekti është bërë para 13 vitesh por sot jemi në një realitet krejt të ri dhe mendoj që edhe Ju e gjykoni të udhës këtë gjë. Ju lutem më lini një takim me drejtuesit e Institucionit Tuaj ose përfaqësues të tij. Do ju marr vetëm 10minuta nga koha Juaj.			
9.4.2026	Autoritetit Rrugor Shqiptar 1-Çfarë parashikon projekti i Korridorit VIII në territorin e Shqipërisë, kur ka nisur zbatimin i tij dhe cilat janë afatet e përfundimit për secilin segment? 2-Sa segmente përfshin projekti, cilat janë ato konkretisht dhe cila është gjatësia totale e segmenteve që po ndërtohen ose rehabilitohen? 3-Cili është buxheti total i projektit, sa është vlera për secilin segment dhe cilat janë burimet e financimit (buxheti i shtetit, kredi, donatorë)? 4-Cilat institucione dhe organizata financiare janë përfshirë në financimin e projektit? 5-Cilat janë kompanitë kontraktore që po zbatojnë punimet për secilin segment dhe cilat procedura prokurimi janë ndjekur për përzgjedhjen e tyre? 6-A ka pasur ndryshime në projektin fillestar gjatë zbatimit dhe cilat janë këto ndryshime? 7-Cili është projekti teknik i miratuar për segmentet e Korridorit VIII që kalojnë pranë ose përgjatë lumit Shkumbin dhe a përfshin ai ndërhyrje në shtratin apo brigjet e lumit? 8-A janë	9.4.2026	Buxheti i ARRSH-se për vitin 2026 akoma nuk është miratuar nga Ministria e Financave. Burimi i financimit është nga buxheti i shtetit.	

		parashikuar në projekt devijime, sistemime apo ndryshime të rrjedhës së lumit dhe në cilat segmente konkrete të rrugës që ndërtohen në afërsi me lumin Shkumbin? 9-Në cilat segmente rruga ndërtohet në afërsi direkte me lumin Shkumbin dhe cila është distanca e saj nga shtrati i lumit në këto zona? 10-A është parashikuar përdorimi i materialeve inerte nga shtrati i lumit për ndërtimin e rrugës dhe në çfarë sasive, si dhe cilat janë kompanitë kontraktore dhe nënkontraktore që kryejnë këto punime? 11-A përfshin projekti masa mbrojtëse për stabilitetin e shtratit dhe brigjeve të lumit dhe a disponon ARR raporte monitorimi mbi ndikimin e punimeve në lumin Shkumbin? 12-A janë konstatuar gjatë zbatimit të projektit ndryshime në konfigurimin e shtratit të lumit apo probleme si erozion, afrim i rrjedhës me trupin e rrugës apo rrezik për infrastrukturën? 13-A janë ndërmarrë ndërhyrje korrigjuese në zonat ku lumi ka ndikuar ose është ndikuar nga ndërtimi dhe cilat institucione janë përfshirë në miratimin dhe monitorimin e këtyre nderhyrjeve.			
10.4.2026	Perpara 7 vjetesh kam plotesuar dokumentacionin e tokes dhe jam Demshperblyer Toka ndodhet ne aksin rrugor,Levan-Tepelene ne fshatin Sheq Musalalaj Toka ka qen ne emer te babait tim Asllan Qazim Lalaj Te githe i kan marr leket , jan demshperblyer, pervec neve , sepe kemi qen jasht shtetit Ju lutem verifikoni gjendjen e ketij problemi tim dhe me ktheni pergjigje Nr im i telefonit:069 44 25 086				
12.4.2026	Jam i interesuar për punë si vëzhgues kamerash (CCTV). Ju lutem më informoni nëse ka vend vakant. Numeri telefoni +355684256394				
12.4.2026	Duke uruar qe te jeni mire dhe qe ky email te merret parasysht dhe te kete nje pergjigje,				

		Ju shkruaj me nje interes shume te madh per me shume informacion rreth nje plani infrastrukturor apo strategjik ne zonen e paskuqanit. Si nje investitor ne tratative qe jam dua te marr vendimin e duhur dhe informacioni qe do me jepni dhe qe me thane te drejtohem te ju duke qene kompetenc e juaja, dua te di me specifikisht rreth nje ure te 2 te ne zonen e paskuqanit ne afersi te poliklinikes po jua demonstroj dhe ne harte... Nje info se ku do jet vendodhja dhe sa do jet koha e konkretizimin do me bente shume pune ne planet e mia. Ne pritje te nje pergjigje sa me te shpejte ju uroj me te mirat dhe pune te mbare.			
16.4.2026		Subjekti “Dulati AL” Sh.p.k ushtron aktivitetin në pronën e ndodhur në Lagjen 14, Shkozë, Bashkia Durrës, dhe disponon dokumentacion të plotë ligjor për zhvillimin e objektit, konkretisht: • Leje sheshi; • Leje ndërtimi me Vendim Nr. 7, datë 10.13.2010; • Leje përdorimi me Nr. 2970/1, datë 24.07.2012; • Kërkesë për punime mirëmbajtjeje me Nr. Prot. 919, datë 27.10.2025, për realizimin e rrethimit të lehtë, pa themele. Referuar projektit dhe zbatimit në terren: • Rrethimi është realizuar / parashikuar me struktura të lehta, pa themele, lehtësisht të çmontueshme; • Nuk përbën ndërtim të përhershëm dhe nuk cenon trupin e rrugës; • Respekton largësitë e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, konkretisht sipas Kodit Rrugor (Neni 25, pika 5 a-b), duke u vendosur në distancë rreth 5 m nga trupi i rrugës;			

	Ndërhyrja klasifikohet si punim mirëmbajtjeje që nuk kërkon leje ndërtimi, në përputhje me ligjin nr. 107/2014 dhe aktet nënligjore përkatëse. Në këto kushte, rezulton se objekti dhe ndërhyrja në fjalë nuk cenojnë hapësirën rrugore dhe nuk krijojnë pengesa për qarkullimin, duke qenë në përputhje me kërkesat teknike dhe ligjore në fuqi. Bashkëlidhur kësaj shkrese po ju dërgohet i gjithë dokumentacioni përkatës justifikues. Subjekti mbetet i gatshëm për çdo verifikim në terren dhe për bashkëpunim të mëtejshëm me institucionin tuaj.			
16.4.2026	Kam eksperiencë si ish-zjarrfikës me mbi 2 vite përvojë dhe posedoj certifikatë përkatëse në këtë fushë. Jam i interesuar të punoj në shërbimet e emergjencës dhe sigurisë në rrugë/tunele. Aktualisht jetoj në Gjirokastër dhe jam i gatshëm të punoj në zonën e jugut.			
17.4.2026	Kërkesë: Konkretisht në lidhje me rrugën që lidh Tiranën me Korçën, segmenti i shembur mes Librazhdit dhe Pogradecit, rrugën Qukës - Qafë Plloçë, Rrugën e Arbrit dhe urat lidhëse mes Milotit dhe Lezhës që kanë shfaqur probleme. Në vijim për të kuptuar situatën kërkojmë dokumentacion dhe informacion si më poshtë: Konkretisht studime/raportet teknike mbi këto akse, përfshi raportet për arsyet e dëmtimit apo planet/projektet e mirëmbajtjes e riparimit për të gjitha këto akse. Kostot e llogaritura për ndërhyrjet dhe zgjidhjet që ARRSH ka për t'i mbajtur këto akse të hapura.		SEGMENTI I SHEMBUR MES LIBRAZHEDIT DHE POGRADECIT Gjatë zhvillimit të punimeve sipas projektit të zbatimit në segmentin rrugor Librazhd- Pogradec, kanë dalë disa probleme që lidhen me rrëshqitjen e dherave, të cilat janë probleme të natyrës gjeologjike. Gjatë harkut kohor Nëntor 2025 ÷ 12 Shkurt 2026, ka mbizotëruar mot i keq dhe me reshje të shumta shiu e të vazhdueshme. Në këtë zonën “Ligata e Bicit” terreni ka pësuar shumë deformime dhe rrëshqitje të shpatit në një	

			sipërfaqe me shtrirje gjatësore dhe vertikale shumë të madhe, mbi dhe nën gjurmën e projektit të ri që po zbatohet. Kjo rrëshqitje po zhvillohet në Km 17+920 ÷ 18+200 (gjatësia horizontale është 280 ml dhe me shtrirje vertikale 205 ml nga skarpata e rrugës) dhe me një pjerrësi shumë të madhe mbi 60 gradë vertikalisht. Kjo rrëshqitje shoqërohet me çarje të konsiderueshme të sipërfaqes së tokës, fundosje të një shtylle të tensionit të lartë. Gjithashtu kjo rrëshqitje ka prekur edhe dy banesa të zonës “Ligata e Bicit” fshati Dragostunjë dhe është një zonë shumë ujëmbajtëse, si rrjedhim toka e ka humbur kohezionin e saj. Kjo situatë u përkeqësua më datë 01.02.2026 ku pati edhe një rrëshqitje masive duke bllokuar qarkullimin e mjeteve në aksin rrugor Librazhd – Pogradec në progresivat Km 17+920 ÷ 18+200. Nisur nga kjo gjendje e rënduar, e cila po agravon çdo ditë dhe paraqet një rrezik shumë evident për një shkëputje masive të shpatit në të gjithë këtë segment, si dhe duke parë shqetësimin real të ecursisë së rrëshqitjes në këtë segment, Autoriteti Rrugor Shqiptar dërgoi më datë 10.02.2026 për verifikim në terren një grup pune të përbërë nga inxhinierë specialistë, së bashku me inxhinierët e sipërmarrësit dhe mbikëqyrësit të punimeve. Nga vrojtimet në terren dallohet qartë që zona në fjalë është shumë e paqëndrueshme, me shenja të dukshme rrëshqitje dhe çarje të theksuara në një zonë me sipërfaqe rreth 6 Ha (gjatësi 280 ml dhe në gjerësi 205 ml). Në këtë zonë prezenca e ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore ishte e dukshme dhe për pasojë formacioni i shpateve e ka humbur kohezionin duke u bërë i paqëndrueshëm e i rrëshqitshëm, gjë që sjell rrezik serioz në rast të rrëshqitjes së këtij masivi	
--	--	--	--	--

				kaq të madh dheu, duke sjellë dëme të konsiderueshme në makineri dhe jetë njerëzore në kantierin e objektit. Duke e gjykuar shumë të rrezikshme situatën e krijuar në terren, sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi i punimeve kanë pezulluar në mënyrë të menjëhershme punimet në këto progresiva, me qëllim shmangien e fataliteteve të mundshme në jetë njerëzish (stafi që punon në kantier), si dhe në dëmtimeve të natyrës materiale (dëme në makineri, në punimet e realizuara, etj.), si dhe për të mbrojtur përdoruesit e aksit rrugor nacional Elbasan ÷ Pogradec, i cili ndodhet poshtë punimeve të këtij objekti. Edhe në zonën “Arrat e Gurrës” terreni ka pësuar shumë deformime dhe rrëshqitje të shpatit me shtrirje gjatësore dhe vertikale shumë të madhe, mbi dhe nën gjurmën e projektit të ri që po zbatohet. Kjo rrëshqitje u zhvillua në Km 19+100 ÷ 19+300 me konture që shkojnë nga shpati mbi segmentin e ri të rrugës deri në nivelin e lumit Shkumbin, pra duke e përfshirë edhe hekurudhën dhe me një pjerrësi të madhe (gjatësia horizontale është 200 ml dhe me shtrirje vertikale 190 ml). Nga verifikimet në terren dhe në analizën e kushteve gjeologo-inxhinierike dhe hidrogjeologjike të kësaj zone, rezulton se një nga faktorët kryesorë është veprimtaria gërryerse ndër vite e lumit të Shkumbinit që i ka bërë bregut të djathtë të lumit e më pas ka vazhduar me gërryerjen e trupit të trasesë së hekurudhës. Gërryerja lumore ka shkaktuar humbjen e ekuilibrit të shpatit, i cili, ashtu si edhe disa zona të tjera, ka rezultuar shumë ujëmbajtës, si rrjedhim toka e ka humbur edhe kohezionin e saj dhe për pasojë ka ndodhur rrëshqitja e shpateve. Kjo rrëshqitje është shoqëruar me çarje të konsiderueshme të sipërfaqes së tokës, fundosje të shtyllës të tensionit të lartë, të hekurudhës dhe të rrugës ekzistuese duke ndërprerë plotësisht qarkullimin e mjeteve në	
--	--	--	--	--	--

				segmentin Librazhd-Prrenjas. Nga sipërmarrësi i punimeve u punua 10 ditë pa ndërprerje për të bërë të mundur rindërtimin e aksesit të rrugës ekzistese dhe rifillimin e qarkullimit të të gjitha llojeve të automjeteve. Gjithashtu, nga verifikimet e kryera në terren dhe në analizën e kushteve gjeologo-inxhinierike dhe hidrogjeologjike të këtyre zonave, rezulton se një faktor tjetër kryesor aktivizues i kësaj rrëshqitje ka qënë intensiteti i lartë i reshjeve të rëna gjatë harkut kohor Nëntor 2025 ÷ Shkurt 2026. Reshjet intensive dhe të zgjatura kanë rritur ndjeshëm infiltrimin e ujrave sipërfaqësore në formacionet e tokës, duke çuar në ngopjen progresive të dherave dhe rritjen e presionit të ujit në pore. Si pasojë, është reduktuar rezistenca prerëse e formacioneve të tokës duke ulur koeficientin e sigurisë së shpateve dhe duke favorizuar aktivizimin e lëvizjes gravitacionale rreshqitje.	
20.4.2026	Po ju shkruajmë në lidhje me një problematikë që kemi ne si banorë në fshatin Shëngjergj të Bashkisë Maliq, Jemi gati 12 familje që kemi problem me ujin e pijshëm për arsye se ujësjellësi nuk i jep dot zgjidhje pasi duhet bërë një prerje tërthore e asfaltit në rrugën kryesore lapidari podgorie-zvezdë dhe të shtrihet tubacioni i ri nga ana e ujësjellësit. Prerja e asfaltit është me permasat 9m gjatesi x 10cm gjerësi cka lidh një sipërfaqe prej 0.9m2 dhe asfalti do të kthehet në gjendjen e mëparëshme. Shpresojmë të gjejmë një zgjidhje nga ana juaj si autoritet për të na lejuar prerjen e asfaltit pasi nuk kemi zgjidhje tjetër për të kaluar tubacionin për tëmarë ujin e pijshëm !				
21.4.2026	Dua të raportoj një gropë shumë të rrezikshme në rrugë, e cila ndodhet në një pikë të ndjeshme të qarkullimit, në	21.4.2026	Ne pergjigje te ankeses se ardhur sqarojme se rruga "Abedin Çiçi nuk ben pjese ne inventarin e		

		rrethrotullimin që lidh Babrrun me hyrjen e Kamzës, konkretisht në Rruga Abedin Çiçi. Koordinatat e sakta të gropës janë: 41.353617290225564, 19.830227864493686 Kjo gropë ka kohë që ekziston dhe paraqet rrezik serioz për drejtuesit e mjeteve, këmbësorët dhe qarkullimin në përgjithësi. Për shkak të pozicionit të saj në një aks të rëndësishëm lidhës, rreziku është i madh dhe kërkohet ndërhyrje e menjëhershme. Një video që tregon situatën është bashkangjitur këtij emaili për t'ju ndihmuar ta identifikoni qartë problemin. Ju lutem që ekipi përgjegjës ta inspektojë dhe ta rregullojë sa më shpejt këtë problem për sigurinë publike.		rrjetit rrugor kombetar qe administrohet nga ARRSH.	
22.4.2026		Ju shkruaj në lidhje me shpalljen për pozicionin e juristit pranë institucionit tuaj. Do doja nëse është e mundur, të më ndihmonit me disa sqarime shitesë: - Një përshkrim më të detajuar të detyrave dhe përgjegjësive të pozicionit; - Fushat kryesore të aftësive dhe njohurive ku do të bazohet vlerësimi gjatë intervistës; - Nëse dokumentet e kërkuara duhet të dorëzohen të noterizuara; - Nëse ekziston mundësia që dokumentacioni të dërgohet me postë, në vend të dorëzimit fizik.			
22.4.2026		Dëshiroj të bëj një denoncim lidhur me një problem që po ndodh në qytetin e Durrësit. Në rrugën “Asti Gogoli”, në zonën pas shinave të trenit, konkretisht në segmentin që lidh Shkozetin me Lagjen 13 (Plazh), disa banorë të zonës kanë vendosur barriera betoni në rrugë pa asnjë autorizim. Këto pengesa:	23.4.2026	Ne pergjigje te ankeses se ardhur, ju sqarojme se rruga "Asti Gogoli", nuk ben pjese ne inventarin e rrjetit rrugor kombetar qe administrohet nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.	

		Bllokojnë qarkullimin normal të automjeteve Krijojnë rrezik për aksidente Kufizojnë lëvizjen e lirë të qytetarëve dhe mjeteve emergjente			
23.4.2026		Pershendetje. Rr Kastriotet nga kthesa e kamzes deri te ura e institutit eshte e shkaterruar dhe plot me gropa. A keni parashikuar investime? Nese jo te pakten mbyllni gropat se ngelem ne servise. Faleminderit	23.4.2026	Ne pergjigje te ankeses se ardhur, ju sqarojme se Rruga "Kastriotet", nga Ura e kamzes deri tek Kthesa e Institutit, nuk ben pjese ne inventarin e rrjetit rrugor kombetar qe administrohet nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.	
23.4.2026		Duke ju falenderuar per punen e bere mbi lirimin e brezave ne rruget kryesore te Shqiperise, dua te ve ne dukje nje shqetesim shum te madh mbi zaptimin e brezave rrugor te Kthesa e Kamzes perballe Terminalit te Urbaneve te Veriut nga nje Karburant qe ka zaptuar cdo centimeter te trotuarit, pak me poshte prane shinave te trenit ku para pak javesh u aksidentua nje femije per vdekje eshte nje ndertese e vjeter perballe pallateve te reja qe po ashtu ka zaptuar 100% te brezit te kembesorev. Ju lutem beni nje nderhyrje sepse IKMT nuk nderhyn sips ligjit por do urdhera ng lart qe te zbatoje ligjin, nuk ka asnje centimeter hapsire per qytetarin, ju takon ju te jepni nje zgjidhje!	24.4.2026	Ne pergjigje te ankeses se meposhteme ju sqarojme se kryqezimi ne fjale nuk eshte nen administrimin e ARRSH por I perket rrugeve dytesore qe administrohen nga Bashkia.	
28.4.2026		Pershendetje, ne lidhje me Nyjen e Laknasit e cila do te lidhe vetem pjesen nga ana e Kamzes me Autostraden Tr-Dr a do te kete ndonje rishikim te projektit ku ne kete nye te kete akses edhe pjesa e Yrshekut?			
29.4.2026		Të nderuar përfaqësues të Autoriteti Rrugor Shqiptar, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Njësisë Administrative Petrelë dhe Bashkia Tiranë, Në vijim të shqetësimeve të vazhdueshme të banorëve të zonës së Mulletit lidhur me ndotjen akustike nga autostrada Tiranë–			

		Elbasan, bashkëngjitur po ju dërgojmë kërkesën tonë zyrtare për marrjen e masave konkrete për reduktimin e zhurmës. Ju lutemi të shqyrtoni kërkesën dhe të na informoni mbi hapat që do të ndërmerren, si dhe mbi një afat konkret për zgjidhjen e këtij problemi. Duke qenë se kemi pasur komunikime të mëparshme pa përgjigje, kërkojmë që kësaj here të na kthehet një përgjigje zyrtare brenda afatit ligjor prej 10 ditësh pune. Faleminderit për vëmendjen dhe bashkëpunimin.			
29.4.2026		Une jam Aleks rrushi nga Quksi I librazhdit junkam derguar disa dokumenta ne Dt.04-03-26 per te marr nje konfirmim nga ju per Te marr cerfitikaten e tokes time kam dy muaj nuk kam marr asnje konfirmim nga ju edhe as dokumentat nk me jan kthyer nga ju! Ju lutem pres nje pergjigje nga ju			
29.4.2026		Une jam Aleks Rrushi nga Quksi I librazhdit me keni kerkuar disa dokumenta shtes jua kam derguar Dokumentat ne Dt.04-03-26 per te marr nje konfirmim nga ju per Te marr cerfitikaten e tokes time kam dy muaj nuk kam marr asnje konfirmim nga ju edhe as dokumentat nk me jan kthyer mbrapsh			
30.4.2026		Përshëndetje të nderuar, Më poshtë po ju përcjellim një kërkesë për informacion lidhur me projektin “Programi për Integrimin Urban dhe Zhvillimin e Turizmit (PIUTD)”, me fokus në ndërhyrjet infrastrukturore në zonën Sarandë–Ksamil, përfshirë bypass-in e Ksamilit. Kërkesa lidhet me projektimin teknik, zbatimin në terren, procedurat e ndjekura, si dhe dokumentacionin përkatës (teknik, mjedisor dhe administrativ) që lidhet me këtë projekt dhe ndërhyrjet e parashikuara në kuadër të tij.			
30.4.2026		Jam i interesuar për punë si vëzhgues kamerash (CCTV). Ju lutem më informoni nëse ka vend vakant. Numeri telefoni +355684256394			

--	--	--	--	--	--